



**- BESIMI NË PEJGAMBERË
SHEJH MUHAMED EL UTHEJMIN**

**- URIMI I MOSBESIMTARËVE
ME RASTIN E FESTAVE TË TYRE FETARE
SHEJH SALIH EL FEUZAN**

**- CILËSITË DALLUESE TË HADADIVE
SHEJH RABI' EL MEDKHALI**

**- AURETI I MUSLIMANES PARA GRAVE MUSLIMANE
DHE ATYRE MOSBESIMTARE
SHEJH MUHAMED NASIRUDIN ALBANI**

**- HISTORIA E SALIHUT ALEJHIS-SELAM
SHEJH ABDURRAHMAN ES-SADIJ**



**REVISTE ELEKTRONIKE FETARE
VITI I PARË, NUMRI I KATËRT
XHUMADAL ULA 1442 / DHJETOR 2020**

PËRMBAJTJA

AKIDE DHE TEUHID

- [Besimi në pejgamberë](#) – Shejh Muhamed el Uthejmin
- [Gjykimi i urimit të mosbesimtarëve me rastin e festave të tyre fetare](#) – Shejh Salih el Feuzan
- [Gjykimi i të ushqyerit me ushqimet e festave të krishterëve, çifutëve dhe idhujtarëve](#) – Komisioni i Përhershëm për Fetva

MENHEXH

- [Në radhë të parë është Teuhidi](#) – Shejh Ahmed en-Nexhmi
- [Sqarimi i mënyrës së kërkimit të dijes dhe përpjekjes për të pyetur dijetarët](#) – Shejh Muhamed Nasirudin el Albani

TEFSIR

- [Baza në Tefsir \(pjesa e katërt\)](#) – Shejh Muhamed el Uthejmin

FIKH

- [Dispozitat që lidhen me menstruacionet dhe lehoninë](#) – Shejh Muhamed el Uthejmin
- [Rasti kur gruaja nuk ka rrjedhje gjaku](#) – Shejh Muhamed el Uthejmin
- [Gjykimi i marrjes së kapsulave që ndalojnë menstruacionet gjatë kryerjes së haxhit](#) – Shejh Muhamed el Uthejmin
- [Nëse vërtetohet dëmi i kapsulave, çfarë gjykimi kanë ato?](#) – Shejh Muhamed el Uthejmin

GRUPACIONET

- [Cilësitë dalluese të Hadadive](#) – Shejh Rabi' el Medkhali
- [Cili është dallimi midis Hadadizmit dhe Selefizmit](#) – Shejh Rabi' el Medkhali

FAMILJA

- [Aureti i muslimanes përpara grave muslimane dhe atyre mosbesimtare](#) – Shejh Muhamed Nasirudin el Albani

HISTORI

- [Historia e Salihut alejhis-salam](#) – Shejh AbdurRahman es-Sadij

BESIMI NË PEJGAMBERË SHEJH MUHAMED EL UTHEJMIN

Besojmë se Allahu i Lartësuar ka dërguar pejgamberë tek krijesat e Tij:

مُبَشِّرِينَ وَمُنذِرِينَ لئَلَّا يَكُونَ لِلنَّاسِ عَلَى اللَّهِ حُجَّةٌ بَعْدَ الرُّسُلِ ۗ وَكَانَ اللَّهُ عَزِيزًا حَكِيمًا

“Të dërguar që kanë sjellë lajme të mira e kanë paralajmëruar, në mënyrë që njerëzit të mos kenë ndonjë justifikim ndaj Allahut, pas ardhjes së pejgamberëve. Se, Allahu, është i Plotfuqishëm dhe i Gjithëdijshtëm.”¹

Besojmë se pejgamberi i parë është Nuhu dhe i fundit është Muhamedi sal-Allahu alejhi ue sel-lem:

إِنَّا أَوْحَيْنَا إِلَيْكَ كَمَا أَوْحَيْنَا إِلَى نُوحٍ وَالنَّبِيِّينَ مِنْ بَعْدِهِ ۗ

“Ne të shpallëm ty (o Muhamed), ashtu siç i shpallëm Nuhut dhe pejgamberëve pas tij.”²

مَا كَانَ مُحَمَّدٌ أَبَا أَحَدٍ مِّن رِّجَالِكُمْ وَلَكِن رَّسُولَ اللَّهِ وَخَاتَمَ النَّبِيِّينَ

“Muhamedi nuk është babai i askujt prej burrave tuaj, por është i Dërguari i Allahut dhe vula e pejgamberëve.”³

Më i miri i pejgamberëve është Muhamedi, pastaj Ibrahim, pastaj Musai, pastaj Nuhu, pastaj Isai biri i Merjemes, të cilët janë veçuar me Fjalën e Allahut të Lartësuar:

وَإِذْ أَخَذْنَا مِنَ النَّبِيِّينَ مِيثَاقَهُمْ وَمِنْكَ وَمِنْ نُوحٍ وَإِبْرَاهِيمَ وَمُوسَىٰ وَعِيسَىٰ ابْنِ مَرْيَمَ ۗ وَأَخَذْنَا مِنْهُم مِّيثَاقًا عَلِيمًا

“Ne të morëm besën ty (o Muhamed) siç bëmë me pejgamberët e tjerë: me Nahun, Ibrahimin, Musain dhe Isain, të birin e Merjemes. Ne i morëm atyre një besë të vendosur.”⁴

¹ En-Nisa' 165.

² En-Nisa' 163.

³ El Ahzab 40.

⁴ El Ahzab 7.

Besojmë se Sheriati i Muhamedit sal-Allahu alejhi ue sel-lem, i ka përfshirë të gjitha vlerat e sherieve të këtyre pejgamberëve të përmendur, sepse Allahu thotë:

شَرَعَ لَكُمْ مِنَ الدِّينِ مَا وَصَّىٰ بِهِ نُوحًا وَالَّذِي أَوْحَيْنَا إِلَيْكَ وَمَا وَصَّيْنَا بِهِ إِبْرَاهِيمَ وَمُوسَىٰ وَعِيسَىٰ أَنْ
أَقِيمُوا الدِّينَ وَلَا تَتَفَرَّقُوا فِيهِ ۚ

“Ai ka urdhëruar për ju atë Fe, të cilën ta shpalli ty (o Muhamed) dhe që ia pati shpallur Nuhut, Ibrahimit, Musait dhe Isait, duke thënë: “Qëndroni në fenë e drejtë dhe mos u përçani në të!”⁵

Besojmë se të gjithë pejgamberët janë njerëz të krijuar, që nuk kanë ndonjë veçori të Rububijes. Allahu i ka thënë Nuhut – i cili ka qenë pejgamberi i parë – që të thoshte:

وَلَا أَقُولُ لَكُمْ عِنْدِي خَزَائِنُ اللَّهِ وَلَا أَعْلَمُ الْغَيْبَ وَلَا أَقُولُ إِنِّي مَلَكٌ

“Dhe unë nuk ju them se kam thesaret e Allahut apo që e di të fshehtë. As nuk them se unë jam melek.”⁶

Allahu i Lartësuar, e ka urdhëruar Muhamed – i cili ka qenë pejgamberi i fundit – që të thoshte:

لَا أَقُولُ لَكُمْ عِنْدِي خَزَائِنُ اللَّهِ وَلَا أَعْلَمُ الْغَيْبَ وَلَا أَقُولُ لَكُمْ إِنِّي مَلَكٌ ۚ

“Unë nuk ju them se kam thesaret e Allahut apo që e di të fshehtë. As nuk them se unë jam melek.”

Po ashtu të thoshte:

لَا أَمْلِكُ لِنَفْسِي نَفْعًا وَلَا ضَرًّا إِلَّا مَا شَاءَ اللَّهُ ۚ

“Unë nuk mund t’i sjell vetes as dobi, as dëm, përveçse aq sa dëshiron Allahu.”⁷

Gjithashtu të thoshte:

قُلْ إِنِّي لَا أَمْلِكُ لَكُمْ ضَرًّا وَلَا رَشَدًا (21) قُلْ إِنِّي لَنْ يُجِيرَنِي مِنَ اللَّهِ أَحَدٌ وَلَنْ أَجِدَ مِنْ دُونِهِ مُلْتَحَدًا

⁵ Esh-Shura 13.

⁶ Hud 31.

⁷ El En’am 188.

“Thuaj: “Unë nuk mundem t’ju largoj ndonjë dëm e as t’ju sjell ndonjë dobi”. Thuaj: “Edhe mua askush nuk mund të më mbrojë nga dënimi i Allahut; dhe nuk mund të gjej strehim tjetërkund, përveçse tek Ai.”⁸

Ne besojmë se peygamberët janë robër të Allahut, të cilët i ka nderuar me Shpallje, po ashtu i ka cilësuar me shkallën më të lartë të Ubudijes⁹ duke i lëvdur ata. Allahu ka thënë për Nuhun, peygamberin e parë:

ذُرِّيَّةَ مَنْ حَمَلْنَا مَعَ نُوحٍ ۗ إِنَّهُ كَانَ عَبْدًا شَكُورًا

“Ju jeni pasardhës të atyre që Ne i mbartëm me Nuhun! Ai ka qenë vërtet një rob mirënjohës.”¹⁰

Po ashtu ka thënë për Muhamedin sal-lAllahu alejhi ue sel-lem, peygamberin e fundit:

تَبَارَكَ الَّذِي نَزَّلَ الْفُرْقَانَ عَلَى عَبْدِهِ لِيَكُونَ لِلْعَالَمِينَ نَذِيرًا

“I lartësuar qoftë Ai që i ka zbritur Dalluesin (Kuranin që dallon të vërtetën nga e pavërteta) robit të Vet (Muhamedit), që të jetë paralajmërues për krijesat.”¹¹

Ndërsa për peygamberë të tjerë, Allahu ka thënë:

وَاذْكُرْ عِبَادَنَا إِبْرَاهِيمَ وَإِسْحَاقَ وَيَعْقُوبَ أُولِي الْأَيْدِي وَالْأَبْصَارِ

“Kujto robërit Tanë: Ibrahimin, Is’hakun dhe Jakubin, të fortë (në adhurim) dhe të ditur.”¹²

وَاذْكُرْ عِبَادَنَا دَاوُودَ ذَا الْأَيْدِي إِنَّهُ أَوَّابٌ

“Dhe kujtoje robin Tonë të fuqishëm (në adhurim), Daudin, që përherë i drejtohej Zotit.”¹³

وَوَهَبْنَا لِدَاوُودَ سُلَيْمَانَ ۗ نَعَمَ الْعَبْدُ إِنَّهُ أَوَّابٌ

⁸ El Xhin 21-22.

⁹ Të qenit rob i Allahut. (shp)

¹⁰ El Isra’ 3.

¹¹ El Furkan 1.

¹² Sad 45.

¹³ Sad 17.

“Ne i falëm Daudit Sulejmanin, një rob të mrekullueshëm. Ai i drejtohej gjithnjë me pendesë Zotit.”¹⁴

Ndërsa për Isain, birin e Merjemes, ka thënë:

إِنَّ هُوَ إِلَّا عَبْدٌ أَنْعَمْنَا عَلَيْهِ وَجَعَلْنَاهُ مَثَلًا لِّبَنِي إِسْرَائِيلَ

“Isai ishte vetëm një rob, të cilit Ne i dhuruam (pejgamberinë) dhe e bëmë shembull për bijtë e Israilit.”¹⁵

Ne besojmë se Allahu i Lartësuar e ka mbyllur shpalljen me dërgimin e Muhamedit sal-lAllahu alejhi ue sel-lem, duke e dërguar për tek gjithë njerëzit. Allahu i Lartësuar ka thënë:

قُلْ يَا أَيُّهَا النَّاسُ إِنِّي رَسُولُ اللَّهِ إِلَيْكُمْ جَمِيعًا الَّذِي لَهُ مُلْكُ السَّمَاوَاتِ وَالْأَرْضِ ۖ لَا إِلَهَ إِلَّا هُوَ يُحْيِي وَيُمِيتُ ۖ فَأَمِنُوا بِاللَّهِ وَرَسُولِهِ النَّبِيِّ الْأُمِّيِّ الَّذِي يُؤْمِنُ بِاللَّهِ وَكَلِمَاتِهِ وَاتَّبِعُوهُ لَعَلَّكُمْ تَهْتَدُونَ

“Thuaj (o Muhamed): “O njerëz, unë jam i Dërguari i Allahut për të gjithë ju, i Atij që i përket sundimi i qiejve dhe i Tokës. Nuk ka të adhuruar tjetër me të drejtë veç Atij; Ai jep jetë dhe vdekje, prandaj besoni në Allahun dhe në të Dërguarin e Tij, Profetin që nuk di shkrim e lexim e që beson në Allahun dhe Fjalët e Tij! Pasojeni atë, që të jeni në rrugën e drejtë!”¹⁶

Ne besojmë se Sheriati i tij sal-lAllahu alejhi ue sel-lem, është feja Islame, të cilën Allahu i Lartësuar e ka zgjedhur për fe të robërve të Tij, e që nuk pranon tjetër fe nga askush. Allahu i Lartësuar ka thënë:

إِنَّ الدِّينَ عِنْدَ اللَّهِ الْإِسْلَامُ

“Feja e vërtetë dhe e pranuar tek Allahu është vetëm Islami.”¹⁷

Po ashtu ka thënë:

الْيَوْمَ أَكْمَلْتُ لَكُمْ دِينَكُمْ وَأَتَمَمْتُ عَلَيْكُمْ نِعْمَتِي وَرَضِيْتُ لَكُمُ الْإِسْلَامَ دِينًا

¹⁴ Sad 30.

¹⁵ Ez-Zuhruf 59.

¹⁶ El Earaf 158.

¹⁷ Al Imran 19.

“Sot jua përsosa fenë tuaj, e plotësova dhuntinë Time ndaj jush dhe zgjedha që Islami të jetë feja juaj.”¹⁸

Gjithashtu thotë:

وَمَنْ يَبْتَغِ غَيْرَ الْإِسْلَامِ دِينًا فَلَنْ يُقْبَلَ مِنْهُ وَهُوَ فِي الْآخِرَةِ مِنَ الْخَاسِرِينَ

“Kush kërkon tjetër fe përveç Islamit, nuk do t’i pranohet dhe ai në botën tjetër do të jetë i humbur.”¹⁹

Ne besojmë se kush pretendon se ka një fe tjetër të pranuar tek Allahu veç fesë Islame, sikur hebraizmi, krishtërimi apo një tjetër, atëherë personi në fjalë është mosbesimtar (kafir) dhe i kërkohet të pendohet, e nëse nuk pendohet vritet si dezertor i fesë (murted), sepse e ka përgënjeshtuar Kuranin.

Ne besojmë se kush e mohon mesazhin e Muhamedit sal-lAllahu alejhi ue sel-lem drejtuar gjithë njerëzimit, atëherë i ka mohuar të gjithë pejgamberët, edhe pejgamberin e tij që pretendon se e beson dhe e ndjek, sepse Allahu i Lartësuar ka thënë:

كَذَّبَتْ قَوْمُ نُوحٍ الْمُرْسَلِينَ

“Populli i Nuhut, i përgënjeshtroi të dërguarit.”²⁰

Pra, i konsideroi përgënjeshtroes i të gjithë pejgamberëve, edhe pse nuk ka patur pejgamberë të tjerë para Nuhut. Allahu i Lartësuar thotë:

إِنَّ الَّذِينَ يَكْفُرُونَ بِاللَّهِ وَرُسُلِهِ وَيُرِيدُونَ أَنْ يُفَرِّقُوا بَيْنَ اللَّهِ وَرُسُلِهِ وَيَقُولُونَ نُؤْمِنُ بِبَعْضٍ وَنَكْفُرُ بِبَعْضٍ وَيُرِيدُونَ أَنْ يَتَّخِذُوا بَيْنَ ذَلِكَ سَبِيلًا (150) أُولَئِكَ هُمُ الْكَافِرُونَ حَقًّا وَأَعْتَدْنَا لِلْكَافِرِينَ عَذَابًا مُهِينًا

“Vërtet, ata që mohojnë Allahun dhe pejgamberët e Tij dhe dëshirojnë të ndajnë Allahun nga pejgamberët e Tij, duke thënë: “Ne disa i besojmë e disa nuk i besojmë” dhe duke dashur që kështu të zgjedhin një rrugë të ndërmjetme, pikërisht ata janë mohuesit e vërtetë. Ne kemi përgatitur dënim poshtërues për mohuesit.”²¹

Ne besojmë se nuk ka pejgamber pas Muhamedit, të Dërguarit të Allahut sal-lAllahu alejhi ue sel-lem. Kush pretendon pejgamberinë pas tij,

¹⁸ El Maideh 3.

¹⁹ Al Imran 85.

²⁰ Esh-Shuara’ 105.

²¹ En-Nisa’ 150-151.

apo e beson atë që e pretendon pejgamberinë, atëherë ai është mosbesimtar, përgënjeshtres i Allahut, i Pejgamberit të Tij dhe unanimitetit të muslimanëve (ixhmasë).

Përktheu: Besmir Cacani

GJYKIMI I URIMIT TË MOSBESIMTARËVE ME RASTIN E FESTAVE TË TYRE FETARE

SHEJH SALIH EL FEUZAN

Lavdi Allahut, salavatet dhe selamet qofshin mbi të Dërguarin tonë Muhamed, familjen dhe gjithë shokët e tij.

Më pas..

Janë shtuar bisedat rreth gjykimit që ka urimi i mosbesimtarëve me rastin e festave të tyre fetare nga ana e muslimanit, andaj e shikoj si detyrë që të sqaroj atë çfarë mendoj se është e drejtë lidhur me këtë çështje dhe them:

Nuk lejohet urimi i mosbesimtarëve për festat e tyre për shkak të kundravajtjeve të shumta që përmban ky veprim, ku prej tyre:

E para: ky është një lloj miqësimi me ta dhe ne jemi ndaluar që të miqësohemi me mosbesimtarët, sipas shumë argumenteve nga Libri dhe Suneti, siç është thënia e Tij:

يَا أَيُّهَا الَّذِينَ آمَنُوا لَا تَتَّخِذُوا الْيَهُودَ وَالنَّصَارَىٰ أَوْلِيَاءَ بَعْضُهُمْ أَوْلِيَاءُ بَعْضٍ وَمَنْ يَتَوَلَّهُمْ مِنْكُمْ فَإِنَّهُ مِنْهُمْ إِنَّ اللَّهَ لَا يَهْدِي الْقَوْمَ الظَّالِمِينَ

“O besimtarë! Mos i bëni miq e mbrojtës çifutët dhe të krishterët! Ata janë mbrojtës të njëri-tjetrit. Kushdo prej jush që i bën ata miq, është me ata. Vërtet, Allahu nuk i udhëzon në rrugë të drejtë keqbërësit.”²²

Tek miqësimi i tyre bën pjesë edhe urimi; sepse është e ndërtuar mbi dashurinë e tyre dhe të fesë që kanë, e sepse atë që nuk e don, nuk e uron. Po ashtu Allahu i Lartësuar ka thënë:

لَا يَجِدُ قَوْمًا يُؤْمِنُونَ بِاللَّهِ وَالْيَوْمِ الْآخِرِ يُوَادُّونَ مَنْ حَادَّ اللَّهَ وَرَسُولَهُ وَلَوْ كَانُوا آبَاءَهُمْ أَوْ أَبْنَاءَهُمْ أَوْ إِخْوَانَهُمْ أَوْ عَشِيرَتَهُمْ

“Nuk gjen njerëz, që besojnë në Allahun dhe në Ditën e Fundit, që të ushqejnë dashuri ndaj atyre, të cilët kundërshtojnë Allahun dhe të

²² El Maideh: 51.

Dërguarin e tij, edhe në qofshin ata etërit e tyre ose bijtë e tyre, ose vëllezërit e tyre, ose farefisi i tyre.”²³

Nëse jemi ndaluar nga dashuria e të afërmve të cilët e kundërshtojnë Allahun, si qëndron puna për të tjerët?

E dyta: këto urime përmbajnë kënaqësi, miratim dhe nxitje për ato festa. Secila prej këtyre arsyeve është e mjaftueshme për ndalesën e urimit të tyre, e si pra kur këto arsye bashkohen të gjitha?

Përgjigja lidhur me dyshimet e atyre që e lejojnë këtë veprim:

- Lidhur me thënien se muslimani është i detyruar që t’i urojë në rastin kur jeton apo mëson në mesin e mosbesimtarëve, themi:

E para: nuk është e lejuar që muslimani të jetojë në mesin e mosbesimtarëve, përveç në rast nevoje. Lejueshmëria e qëndrimit të tij mbaron atëherë kur mbaron nevoja. Të kapurit pas Fesë së Allahu, gjithashtu është kusht për lejimin e këtij qëndrimi.

E dyta: këta muslimanë nuk i ka detyruar ndonjëri që të qëndrojnë në ato vende që të thuhet "ky urim bëhet për domosdoshmëri dhe largimin e dëmit prej nesh". Muslimani krenohet me Fenë e tij dhe nuk është lajkatar, përkundrazi ai thotë:

لَكُمْ دِينُكُمْ وَلِي دِينِ

“Ju keni fenë tuaj, ndërsa unë kam fenë time!”²⁴

- Sa i përket atyre që thonë: "Siç na urojnë ata neve për festat tona, po ashtu edhe ne i urojmë për festat e tyre; këtë e bëjmë si përgjigje ndaj të mirës së tyre".

Themi: festat tona janë të vërteta, ndërsa festat e tyre –sidomos ato të shpikurat – janë të kota, kështu që as nuk i miratojmë dhe as që i urojmë ata.

- Sa i përket argumentimit për lejueshmërinë e urimit të festave të tyre me thënien e Allahut të Lartësuar:

لَا يَنْهَاكُمْ اللَّهُ عَنِ الدِّينِ لَمْ يُقَاتِلُوكُمْ فِي الدِّينِ وَلَمْ يُخْرِجُوكُمْ مِنْ دِيَارِكُمْ أَنْ تَبَرُّوهُمْ وَتُقْسِطُوا إِلَيْهِمْ

²³ El Muxhadeleh: 22.

²⁴ El Kafirun: 6.

“Allahu nuk ju ndalon të silleni mirë dhe të jeni të drejtë ndaj atyre që nuk luftojnë kundër jush për shkak të fesë dhe që nuk ju dëbojnë prej shtëpive tuaja.”²⁵

Themi: ky argumentim nuk është me vend, sepse këtu është për qëllim sjellja e mirë me ta për çështjet e lejuara, ndërsa urimi i festave që ata kanë, nuk është e lejuar, kështu që nuk ka mirësjellje në këtë pikë.

- E sa i përket thënies: "Kjo bëhet për shkak të thirrjes në rrugë të Allahut".

Themi: thirrja për tek Allahu nuk bëhet me ato gjëra që jemi ndaluar prej tyre, siç është miqësimi me ta, mirëpo bëhet me atë që ka ligjëruar Allahu.

Salavatet dhe selamet qofshin mbi të Dërguarin tonë Muhamed, familjen dhe gjithë shokët e tij.

Shkruar nga: **Salih ibën Feuzan el Feuzan**

Anëtar i Komitetit të Dijetarëve të Mëdhenj

17-02-1433

Përktheu: Besmir Cacani

²⁵ El Mumtahineh: 8.

GJYKIMI I TË USHQYERIT ME USHQIMET E FESTAVE TË KRISHTERËVE, ÇIFUTËVE DHE IDHUJTARËVE

KOMISIONI I PËRHERSHËM PËR KËRKIME SHKENCORE DHE FETVA

Pyetja: a lejohet që muslimani të ushqehet prej ushqimeve të përgatitura nga të krishterët, çifutët apo idhujtarët me rastin e festave të tyre? A lejohet që të pranojë prej tyre dhurata me rastin e këtyre festave?

Përgjigjja: muslimanit nuk i lejohet të ushqehet prej ushqimeve që të krishterët, çifutët apo idhujtarët kanë përgatitur me rastin e festave të tyre. Gjithashtu, muslimanit nuk i lejohet të pranojë dhuratë prej tyre me rastin e këtyre festave, për shkak se kjo gjë përmban nderim për ta, bashkëpunim me ta në shfaqjen e simboleve të tyre, përmban reklamim të bidateve të tyre dhe përmban pjesëmarrje në gëzimin e festave të tyre. Kjo mund të dërgojë deri në marrjen e festave të tyre si festa për ne, apo në shkëmbimin e ftesave për sofrë, apo të dhuratave në festat tona apo festat e tyre mësë paku. Kjo gjë bën pjesë tek fitnet dhe bidatet në fë. Është vërtetuar se Pejgamberi sal-Allahu alejhi ue sel-lem ka thënë:

من أحدث في أمرنا هذا ما ليس منه فهو رد

“Kush shpikën diçka në fenë tonë që nuk është pjesë e saj, atëherë ajo është e refuzuar.” Transmeton Buhariu, Muslimi, Ebu Daudi, Ibën Maxheh dhe Ahmedi.

Po ashtu nuk lejohet t’u bësh dhuratë atyre me rastin e festave të tyre.

Prej Allahut vjen sukcesi, salavatet dhe selamet qofshin mbi të dërguarin tonë Muhamed, familjen dhe shokët e tij.

Kryetar: AbdulAziz ibën Abdullah ibën Baz

Nënkryetar: AbdurRezak Afifi

Anëtar: Abdullah ibën Ku’ud

Përktheu: Besmir Cacani

GJYKIMI I URIMIT TË KRISHTERËVE PËR FESTAT E TYRE DHE MUNDËSIMI I GJËRAVE QË U NEVOJITEN PËR FESTAT E TYRE

SHEJH MUHAMED EL UTHEJMIN

Pyetja: shejh i nderuar! Në fund të vitit gregorian, disa furra buke dhe librari i mundësojnë të krishterëve gjërat që u nevojiten për festat e krishtlindjeve, e kjo duke shkruar mbi embëlsira dhe torta fjalë sikur: përshumvjet e në gëzime, gëzuar apo vit të mbarë. Këto librari po ashtu i mundësojnë edhe kartolinat, andaj çfarë gjykimi ka kjo gjë?

A keni ndonjë këshillë për furrëtarët të cilët mund të kenë punëtorë jomuslimanë dhe e bëjnë këtë gjë? Shpresoj një përgjigje të mjaftueshme, që t’jua përcjell atyre dhe Allahu ju shpërbleftë.

Ndërsa një tjetër thotë lidhur me të njëjtën temë: çfarë mendoni rreth shpërndarjes së fetvasë suaj, që është lëshuar rreth gjykimit të urimit të krishterëve për festat e tyre.

Përgjigja: fillojmë nga pyetja e fundit. Shpërndarja e asaj që kemi shkruar lidhur me urimin e të krishterëve për festat e tyre është diçka që kërkohet [bërja e saj]. Shpresojmë që Allahu ta shpërblejë njeriun që ndihmon në këtë gjë. Kjo, në mënyrë që muslimanët të bëhen me dije, se urimi i të krishterëve për festat e tyre është i ndaluar me pajtim të dijetarëve; siç e ka përcjellë këtë gjë Ibën Kajimi Allahu e mëshiroftë në librin e tij “Ahkamu ehli edh-dhimmeh”. Kjo, sepse uruesi po i uron për simbolet e mosbesimit dhe është sikur po i uron për adhurimin e kryqit, apo ngrënien e derrit, apo konsumimin e alkoolit apo të ngjashme. Shpërndarja e fetvasë me qëllim që njerëzit të bëhen me dije për gjykimin fetar, që mos të mashtrohen dhe mos të vazhdojnë në këtë gjë, kjo është vepër e mirë dhe inshaAllah njeriu shpërblehet për të.

Sa i përket shoqërimit të tyre në festa duke i uruar, duke bërë ushqimet e të ngjashme, kjo është haram. Edhe nëse është diçka më e vogël se urimi, ajo gjithashtu është haram. Për këtë arsye, [mosbesimtarët] ndalohen që t’i shfaqin simbolet e festave të tyre në vendet muslimane dhe, nuk lejohet që ata t’i shfaqin simbolet e fesë së tyre në vendet muslimane.

Përktheu: Besmir Cacani

NË RADHË TË PARË ËSHTË TEUHIDI SHEJH AHMED IBËN JAHJA EN-NEXHMI

Me emrin e Allahut, Mëshireplotit, Mëshiruesit

Përse Teuhidi është i pari?

Gjithë lavdërimet i takojnë Allahut, lëvdata dhe shpëtimi janë për të Dërguarin e Allahut, mbi familjen e tij, shokët e tij, e më pas:

Një telefonues më kërkoi të them disa fjalë në temën se përse Teuhidi është i pari? Kjo tregon se telefonuesi e ka njohur Teuhidin si bazë të besimit Islam, themelin, kushtin e pranimit dhe refuzimit të tij. Këtë propozim e ka bërë që ta kuptojë ai që ende se ka kuptuar pozitën e Teuhidit në fenë Islame.

Kjo, sepse Teuhidi i adhurimit është pikërisht ai për të cilin janë urdhëruar gjithë të dërguarit, nga i pari i tyre, Nuhu alejhis-salatu ues-selam, deri tek i fundit, Muhamedi sal-lAllahu alejhi ue sel-lem.

Allahu i Lartësuar thotë:

ولقد بعثنا في كل أمة رسولا أن اعبدوا الله واجتنبوا الطاغوت

“Sigurisht që Ne tek çdo popull sollëm të dërguar (që t’u thonë atyre): “Adhuroni Allahun dhe largohuni Tagutit (çdo gjejë që adhurohet veç Allahut)”.²⁶

Allahu i Lartësuar thotë:

وما أرسلنا من قبلك من رسول إلا نوحى إليه أنه لا إله إلا أنا فاعبدون

“Ne nuk dërguam asnjë të dërguar para teje e të mos i kemi shpallur atij se: nuk ka të adhuruar tjetër me të drejtë përveç Meje, pra më adhuroni Mua”.²⁷

Çdo pejgamber që dergohej tek populli i tij, thoshte:

يا قوم اعبدوا الله ما لكم من إله غيره

²⁶ En Nahl 36.

²⁷ El Enbija 25.

“O popull! Adhuroni Allahun, ju nuk keni ndonjë të adhuruar tjetër përveç Tij”.²⁸

Kur Allahu e dërgoi Muhamedin, Pejgamberin tonë sal-IAllahu alejhi ue sel-lem për tek populli i tij, ai qëndroi dhjetë vjet duke ftuar vetëm në Teuhid. Namazi u ligjërue pas vitit të dhjetë. Në Meke qëndroi edhe tre vjet, pastaj emigroi në Medine, ku në vitin e dytë të emigrimit u ligjeruan zekati dhe agjërimi. Kjo, sepse Teuhidi është baza e fesë, themeli dhe shtylla e saj mbi të cilën ngrihet. Ky është shkaku se kush e prish Teuhidin duke lutur me Allahun të adhuruar të tjerë, e ka prishur të gjithë fenë, ka dalë nga Islami, është bërë murted (renegat) dhe i është shkatërruar puna.

Allahu i Lartësuar thotë:

ولقد أوحى إليك وإلى الذين من قبلك لئن أشركت ليحبطن عملك ولتكوننَّ من الخاسرين

“Vërtet që ty dhe atyre para teje ju është shpallur se: nëse bën shirk, puna jote do të shkatërrohet dhe do të jesh prej të humburve”.²⁹

Isai alejhis-selam ka thënë:

يا بني إسرائيل اعبدوا الله ربي وربكم إنه من يشرك بالله فقد حرم الله عليه الجنة ومأواه النار وما للظالمين من أنصار

“O bijtë e Israilit! Adhuroni Allahun, Zotin tim dhe Zotin tuaj. Kush i bën shirk Allahut, atij Allahu ia ka bërë haram Xhenetin, përfundimi i tij është Zjarri dhe për zullumqarët nuk do gjesh ndihmues”.³⁰

Ky themel madhështor ka përmbledhur dëshminë La ilahe il-IAllah, Muhamedun Resulullah, që përbëhet nga dy pjesë. “La ilahe il-IAllah” është pjesa e parë që mohon adhurimin e çdo gjëje veç Allahut azze ue xhel-le. Fjala “eshhedu en la ilahe” do të thotë se nuk ka të adhuruar me të drejtë në Gjithësi përveç Allahut. Pjesa e dytë “il-IAllah”³¹ është pohimi i adhurimit për Allahun të vetëm e pa ortak, sepse Ai e ka krijuar këtë gjithësi.

Allahu i Lartësuar thotë:

²⁸ El Araf 59.

²⁹ Ez Zumer 65.

³⁰ El Maideh 72.

³¹ Përveç Allahut. (shp)

قل أئنكم لتكفرون بالذي خلق الأرض في يومين وتجعلون له أندادا ذلك رب العالمين

“Thuaj: “A jeni ju që mohoni Atë i Cili krijoi Tokën në dy ditë dhe i përshkruani Atij të ngjashëm?! Ai është Zoti i boteve”.³² Dhe ajetet ne vijim.

Allahu i Lartësuar thotë:

الله الذي جعل لكم الأرض قرارا والسماء بناء وصوركم فأحسن صوركم ورزقكم من الطيبات ذلكم ربكم فتبارك الله رب العالمين - هو الحي لا إله إلا هو فادعوه مخلصين له الدين الحمد لله رب العالمين - قل إني نهيته أن أعبد الذين تدعون من دون الله لما جاءني البيئات من ربي وأمرت أن أسلم لرب العالمين

“Allahu është Ai i cili e bëri Tokën vendbanim për ju dhe qiellin kulm, ju formësoi në formën më të mirë, ju dha furnizim prej të mirave, ky pra është Zoti i juaj i Lartë, pra, është Allahu Zoti i botëve. Ai është i Gjalli që nuk ka të adhuruar me të drejtë veç Tij, pra adhurojeni Atë me adhurim të singertë, të gjitha lavdërimet janë për Allahun, Zotin e Gjithësisë. Thuaj: “Unë jam ndaluar të adhuroj ata që ju i adhuroni veç Allahut, ndërkohë që më kanë ardhur argumente të qarta prej Zotit tim dhe jam urdhëruar t’i dorëzohem Zotit të boteve”.³³

Ajetet që argumentojnë veçimin e Allahut në adhurim janë të shumta. Kush e shpreh këtë dëshmi, dëshminë se nuk ka të adhuruar me të drejtë përveç Allahut dhe se Muhamedi është i Dërguari i Allahut, ka fituar dhe i ka shpëtuar humbjes.

Allahu i Lartësuar thotë:

والعصر - إِنَّ الْإِنْسَانَ لَفِي خَسْرٍ - إِلَّا الَّذِينَ آمَنُوا وَعَمِلُوا الصَّالِحَاتِ وَتَوَّصُوا بِالحَقِّ وَتَوَّصُوا بِالصَّبْرِ

“Betohem për kohen! Nuk ka asnjë dyshim që njeriu është në humbje të sigurtë. Përveç atyre që besuan, punuan vepra të mira, këshilluan mes veti me të vërtetën dhe këshilluan mes veti për durim”.³⁴

Allahu i Lartësuar thotë:

³² El Fusilet 9.

³³ Gafir 64- 66.

³⁴ El Asr 1-3.

لذین آمنوا ولم یلبسوا إیمانهم بظلم أولئک لهم الأمن وهم مهتدون

“Ata që besuan dhe besimin e tyre nuk e përlyen me padrejtësi, për ta është siguria dhe ata janë të udhëzuarit”.³⁵

Kush e thotë atë³⁶ duke besuar në kuptimin e saj dhe duke punuar me atë çka kërkon ajo, atëherë ai ka arritur lumturinë në të dy botët. Ajo është fjala me të cilën Allahu dërgoi të dërguarit, zbriti me të librat e Tij dhe për shkak të saj janë krijuar Dynjaja dhe Ahireti, Xheneti dhe Zjarri, e sipas saj janë lumturia ose mjerimi. Pohuesit dhe besimtarit të saj, do t’i jepet libri nga e djathta, do t’i rëndohet peshorja e veprave të mira, do të kalojë Siratin, do të hyjë në Xhenet, do të shpëtojë nga Zjarri dhe rreth saj do të merret në pyetje.

Allahu i Lartësuar thotë:

فلنسالنَّ الذین أرسل إلیهم ولنسالنَّ المرسلین

“Ne patjetër do t’i marrim në pyetje ata të cilëve u është dërguar (pejgamber), e do t’i marrim në pyetje edhe të dërguarit”.³⁷

Allahu i Lartësuar thotë:

ویوم ینادیهم فیقول ماذا أجبتم المرسلین - فعمیت علیهم الأنباء یومئذٍ فهم لا یتساءلون - فأما من

تاب وآمن وعمل صالحاً فعسی أن یکون من المفلحین

“Përkujto Ditën kur (Allahu) i thërret dhe i thotë: “Çfarë përgjigje i keni dhënë të dërguarve?” Atë Ditë, atyre do t’i humbin faktet dhe ata nuk do të konsultohen ndërmjet tyre. E sa i përket atij që është penduar, ka besuar edhe ka bërë vepra të mira, ai do të jetë prej të shpëtuarve”.³⁸

Thotë shejhu ynë Hafidh ibën Ahmed El Hakemi, Allahu e mëshiroftë, në “Mearixhul Kabul”:³⁹

“Ajo (fjala La ilahe il-lAllah) është mirësia më e madhe që Allahu i ka dhënë robërve të Tij, të cilët i ka udhëzuar tek ajo, e për këtë shkak e ka

³⁵ El Enam 82.

³⁶ D.m.th. fjalën La ilahe il-lAllah. (shp)

³⁷ El Araf 6.

³⁸ El Kasas 65-67.

³⁹ 2\510 botimet Ibnul Xheuzij.

përmendur në suren en-Nahl, e cila është surja e mirësive përpara çdo mirësie. Ka thënë:

ينزل الملائكة بالروح من أمره على من يشاء من عباده أن أنذروا أنه لا إله إلا أنا فاتقون

“Me urdhërin e Tij melaiket zbresin me shpallje atij që Ai dëshiron nga robërit e vet (duke thënë): “Paralajmëroni se nuk ka të adhurar me të drejtë përveç Meje, pra të më keni frikën”.⁴⁰

Ajo është fjala e dëshmisë dhe çelësi i lumturisë, ajo është baza e fesë, themeli, kryesorja, trangu dhe shtylla e saj. Pjesa tjetër e shtyllave të fesë dhe obligimeve degëzohen e dalin prej saj, e plotësojnë, e specifikojnë duke bërë obligim të kuptuarit e saj dhe të punuarit me çfarë kërkon. Ajo është lidhja e fortë për të cilën Allahu azze ue xhel-le thotë:

فمن يكفر بالطاغوت ويؤمن بالله فقد استمسك بالعروة الوثقى لا انفصام لها والله سميعٌ عليم

“Kush e mohon Tagutin dhe beson Allahun, ai është kapur për lidhjen me të fortë e cila nuk këputet, e Allahu është Dëgjuesi i çdo gjëje dhe i Gjithëdijshmi.”⁴¹

Ajo është besa për të cilën thotë Allahu azze ue xhel-le:

لا يملكون الشفاعة إلا من اتخذ عند الرحمن عهدا

“Nuk ka të drejtë ndërmjetësimi askush, përveç atij që i ka dhënë besë i Gjithëmëshirshmi”.⁴²

Abdullah ibën Abasi, radijAllahu anhu, thotë në komentimin e bësës: “Ajo është dëshmia La ilahe il-lAllah, po ashtu distancimi nga forca dhe fuqia, përveç nga Allahu. Ajo është “e mira” për të cilën Allahu azze ue xhel-le thotë:

فأما من أعطى واتقى - وصدق بالحسنى - فسنيسره لليسرى

“E sa i përket atij që jep dhe ruhet, që vërteton bindshem për të mirën, Ne do ta përgatisim atë për më të lehtë”.⁴³

Ajo është fjala e vërtetë, të cilën Allahu e ka përmendur në fjalën e Tij:

⁴⁰ En Nahl 2.

⁴¹ El Bekare 256.

⁴² Merjem 87.

⁴³ El Lejl 5-7.

إِلَّا مَنْ شَهِدَ بِالْحَقِّ وَهُمْ يَعْلَمُونَ

“Përveç kush dëshmoi të vërtetën, e ata e dinë”.⁴⁴

Ajo është fjala e devotshmërisë, të cilën Allahu azze ue xhel-le e ka përmendur në fjalën e Tij

وَأَلْزَمَهُمْ كَلِمَةَ التَّقْوَىٰ وَكَانُوا أَحَقَّ بِهَا وَأَهْلَهَا

“Ai zgjodhi për ta fjalën e devotshmërisë, sepse ata ishin më meritorë për të dhe më të zotët e saj”.⁴⁵ Përfundoi shkurtimisht ajo çfarë desha të percjell.

Nga këtu na është bërë e ditur pse Teuhidi është i pari në zbatim, i pari në thirrje, baza e fesë, themeli dhe shtylla e saj. Islami pa Teuhid është si një ndërtesë pa kolona. Gjithashtu bëhemi me dije për humbjen e atyre që thërrasin në kundërshtim të tij dhe pretendojnë se thërrasin në kthimin e hilafetit të humbur.

Ne themi se Allahu na ka urdhëruar me Teuhid, për të cilin kanë thirrur gjithë të dërguarit. Allahu do na pyesë çfarë adhuroat? Si iu përgjigjet të dërguarve? Sa humbje dëshpëruese për atë që e kaloi gjithë jetën e tij në thirrje për të kundërtën e saj! Sa humbje për atë që i përgjigjet dhe e pason në këtë humbje!

Lëvdata dhe shpëtimi është për Pejgamberin Muhamed, mbi familjen dhe shokët e tij.

Përktheu: Jusuf Kapidani

⁴⁴ Ez Zuhruf 86.

⁴⁵ El Feth 26.

SQARIM I MËNYRËS SË KËRKIMIT TË DIJES DHE PËRPJEKJES PËR TË PYETUR DIJETARËT

SHEJH MUHAMED NASIRUDIN ALBANI

Lavdi Allahut, Atë e lavdërojmë, prej Tij ndihmë dhe falje kërkojmë. Kërkojmë strehim tek Allahu nga e keqja e veteve dhe veprave tona. Atë që Allahu e udhëzon, nuk ka kush e humbet, ndërsa atë që e humbet Allahu, nuk ka kush e udhëzon. Dëshmoj se nuk ka të adhuruar me të drejtë përveç Allahut të Vetëm e të pashok dhe se Muhamedi është robi dhe i Dërguari i Tij.

﴿ يَا أَيُّهَا الَّذِينَ آمَنُوا اتَّقُوا اللَّهَ حَقَّ تَقَاتِهِ وَلَا تَمُوتُنَّ إِلَّا وَأَنتُمْ مُسْلِمُونَ ﴾

“O ju të cilët keni besuar! Kijeni frikë Allahun ashtu si i takon Atij dhe vdisni vetëm duke qenë muslimanë!”⁴⁶

﴿ يَا أَيُّهَا النَّاسُ اتَّقُوا رَبَّكُمُ الَّذِي خَلَقَكُمْ مِنْ نَفْسٍ وَاحِدَةٍ وَخَلَقَ مِنْهَا زَوْجَهَا وَبَثَّ مِنْهُمَا رِجَالًا كَثِيرًا وَنِسَاءً وَاتَّقُوا اللَّهَ الَّذِي تَسَاءَلُونَ بِهِ وَالْأَرْحَامَ إِنَّ اللَّهَ كَانَ عَلَيْكُمْ رَقِيبًا ﴾

“O njerëz! Frikësojuni Zotit tuaj, i Cili ju krijoi prej një njeriu, ndërsa prej atij krijoi bashkëshorten e tij, kurse prej këtyre të dyve krijoi shumë meshkuj e femra. Frikësojuni Allahut, me emrin e të Cilit ju kërkon të drejtat e ndërsjella dhe ruani lidhjet farefisnore, se vërtet, Allahu është përherë Mbikëqyrës mbi ju.”⁴⁷

﴿ يَا أَيُّهَا الَّذِينَ آمَنُوا اتَّقُوا اللَّهَ وَقُولُوا قَوْلًا سَدِيدًا يُصْلِحْ لَكُمْ أَعْمَالَكُمْ وَيَغْفِرْ لَكُمْ ذُنُوبَكُمْ وَمَنْ يُطِعِ اللَّهَ وَرَسُولَهُ فَقَدْ فَازَ فَوْزًا عَظِيمًا ﴾

“O besimtarë! Frikësojuni Allahut dhe thoni vetëm të vërtetën. Ai do t’ju bekojë veprat tuaja dhe do t’ju falë gjynahet. Kush i bindet Allahut dhe të Dërguarit të Tij, do të arrijë një fitore madhështore.”⁴⁸

Pas kësaj:

Në tubimet e kaluara, kemi tërhequr vëmendjen se prej mënyrave të ligjëruara lidhur me mësimin e njerëzve Fenë e tyre, është edhe shtrimi i

⁴⁶ Al Imran 102.

⁴⁷ En-Nisa’ 1.

⁴⁸ El Ahzab 70.

pyetjeve dhe më pas përgjigjja ndaj tyre. Këtë metodë e ka miratuar Allahu (Ligjvënësi i Urtë), sepse Ai tebareke ue teala e di se njerëzit nuk ndjekin të gjithë të njëjtin drejtim lidhur me mësimin e dispozitave të Fesë së tyre.

Të gjithë e dinë se metoda e ndjekur për të mësuar, është ajo e hallkave (tubimeve) të dijes që kanë qenë më herët, e të cilat vazhdojnë nga pak deri në kohën tonë. Kjo është metoda e marrjes së diturisë; ku në këto (hallka apo tubime) mblidhen ata që kanë dëshirë dhe zell për të kërkuar diturinë me disa prej dijetarëve, në xhami apo në ndonjë vend tjetër. Kështu pra, ata e marrin nga dijetari dijen që dëshirojnë përmes tubimeve të rregullta.

Siç e vërejte, kësaj gjëje i nevojitet një lloj i caktuar njerëzish, ku ata duhet të jenë:

Së pari: të kenë dëshirë dhe zell për të kërkuar diturinë në formë të rradhitur dhe të rregullt.

Së dyti: të jenë të përgatitur nga zgjuarsia, mësimi përmendësh apo të ngjashme.

Së treti dhe e fundit: të kenë kohë që i ndihmon në renditjen e kërkimit të diturisë sipas kësaj metode, e cila është ajo e hallkave dhe tubimeve të dijes.

Pra, sikurse thashë më lart, shumë prej njerëzve nuk i gjejnë tek vetet e tyre këto veçori që duhet t'i plotësojë nxënësi i dijes. Ndoshta këto veçori plotesohen tek disa, mirëpo nuk e kanë dijetarin që kërkojnë dhe dëshirojnë të mësojnë prej tij, ose e gjejnë dijetarin, mirëpo ai nuk ka kohë të lirë.

Për këtë shkak, Allahu azze ue xhel-le ka ligjëruar një metodë dhe mënyrë tjetër për marrjen e dijes, e kjo sikur është bërë një realitet bashkëkohor për shkak të mjeteve që afrojnë zërat, e me këtë kam për qëllim telefonin në mënyrë specifike. Pyetjet që bëhen përmes telefonit janë të shumta, ku me këtë mënyrë njerëzit mësojnë atë që kanë nevojë.

Pastaj, prej dallimeve që duken qartë mes metodës së ndjekur në kohët e hershme – dhe ajo metodë është marrja e dijes nga dijetarët – dhe mes metodës së pyetje-përgjigjes, është se metoda e pyetjes i jep pyetësit liri të bëjë pyetje që lidhen me të personalisht, apo që kanë lidhje me familjen e tij; familje për të cilën ai është përgjegjës.

Kurse me metodën e parë, njeriu mund të mësojë gjëra që nuk e ndjen veten se ka nevojë për to, edhe pse më vonë do ta vërejë dobinë e kërkimit të dijes sipas kësaj metode, sidomos nëse ai kërkon që të bëhet prej

dijetarëve një ditë prej ditëve. Përderisa shumica e njerëzve nuk i kanë këto veçori, Allahu azze ue xhel-le ka ligjëruar këtë metodë të kërkimit të dijes, metodë e cila është ajo e pyetje-përgjigjes, sikurse thotë Allahu azze ue xhel-le në Kuranin Fisnik:

﴿ فَاسْأَلُوا أَهْلَ الذِّكْرِ إِنْ كُنْتُمْ لَا تَعْلَمُونَ ﴾

“Dhe pyesni dijetarët nëse nuk dini.”⁴⁹

Në këtë ajet fisnik, Allahu azze ue xhel-le e ka ndarë shoqërinë Islame në dy pjesë nga aspekti i lidhjes së tyre me diturinë: njëra pjesë nuk ka dituri, kurse pjesa tjetër ka dituri, dhe secilës pjesë i ka vendosur një detyrë.

Atyrë që nuk kanë dituri, i ka vënë për detyrë që të mësojnë përmes metodës së pyetjes. Ndërsa atyre që u drejtohen pyetjet, i ka vënë për detyrë që të përgjigjen, dhe ky ajet është i qartë për këtë gjë:

﴿ فَاسْأَلُوا أَهْلَ الذِّكْرِ إِنْ كُنْتُمْ لَا تَعْلَمُونَ ﴾

“Dhe pyesni dijetarët nëse nuk dini.”⁵⁰

Pejgamberi sal-lAllahu alejhi ue sel-lem e ka konfirmuar këtë gjë në hadithin e saktë që përcillet nga Ebu Daudi etj, e ky i fundit nga Xhabir ibën Abdullah el Ensarij radijAllahu anhu, se Pejgamberi sal-lAllahu alejhi ue sel-lem ka dërguar një ekspeditë – d.m.th. ka përgatitur një ushtri që të luftojë në rrugë të Allahut –, e më pas i ka caktuar ekspeditës një prijës (drejtues) siç është Suneti. Ekspedita (es-Serijeh), është ajo që bën luftë, mirëpo në të nuk bën pjesë Pejgamberi sal-lAllahu alejhi ue sel-lem. E kundërta e saj e ekspeditës është beteja (gaz’ueh), për të cilën Pejgamberi sal-lAllahu alejhi ue sel-lem është komandanti dhe drejtuesi i saj. Pra, një ditë prej ditëve, Pejgamberi sal-lAllahu alejhi ue sel-lem dërgoi një ekspeditë dhe pjesëtarët e saj shkuan dhe luftuan mosbesimtarët. Pasiqë u bë natë, pasi lufta pushoi, pasi (muslimanët) falën namazin e jacisë dhe më pas fjetën, në sabah u zgjuan për të falur namazin, kur, njëri prej tyre e pa veten se kishte ejakuluar dhe i ishte bërë detyrë të lahej (të merrte gusël). Mirëpo, ai në luftë ishte plagosur me shumë plagë në trup, kështu që pyeti ata që kishte përreth tij se mos i gjenin ndonjë lehtësim për mos t’u larë, por të merrte tejemum. Ata thanë: “Jo! Duhet me doemos që të lahesh.” Personi në fjalë u lëshua dhe për rrjedhojë ai vdiq; temperatura iu rrit, plagët iu rënduan dhe si rrjedhojë vdiq

⁴⁹ En-Nahl: 43.

⁵⁰ En-Nahl: 43.

dhe ndërroi jetë. Pasi mbërriti lajmi tek Pejgamberi sal-lAllahu alejhi ue sel-lem, ai u zemërua shumë dhe bëri dua ndaj atyre që kishin dhënë fetva për mos-lejimin e marrjes tej mum për të plagosurin, dhe tha:

(قتلوه قاتلهم الله، ألا سألوا حين جهلوا، وإنما شفاء العي السؤال)

“E vranë, i vraftë Allahu! Përse nuk pyetën kur nuk dinin. Vërtetë shërimi i padijes është pyetja.”

Argumenti nga ky hadith, është se Pejgamberi sal-lAllahu alejhi ue sel-lemi ka nxitur ata që dhanë fetva pa dije, se duhet të kishin pyetur, në mënyrë që përgjigjja e tyre të buronte nga dijetarët. Mirëpo, kur ata nuk ishin të ditur, i dhanë fetva të plagosurit me padijen e tyre, e ajo fetva u bë shkak për vrasjen dhe vdekjen (e të plagosurit). Kjo është arsyeja përse pyetja bën pjesë tek mënyrat e ligjëruara për marrjen e diturisë, sikurse e përmendëm.

Më pas, sikurse edhe përmendëm tek ajeti më lart, Zoti ynë azze ue xhel-le, i ka vënë detyrë pjesës së dytë të shoqërisë Islame – të cilët janë dijetarët – , i ka vënë për detyrë që të japin përgjigje. Nëse dijetari pyetet për një çështje që ka dituri rreth saj, nuk i lejohet që mos të japë përgjigje, sepse Pejgamberi sal-lAllahu alejhi ue sel-lem thotë në hadithin e saktë dhe të njohur:

من سئل عن علم فكتمه، أجم يوم القيامة بلجام من نار

“Kush pyetet për një çështje të dijës dhe e fshehën atë, atëherë në Ditën e Gjykimit atij i vendosen frerë prej Zjarri.”

Prej edukatës së pyetjes – dhe po e përmendim me këtë rast – është që muslimani të pyesë për çështjet që lidhen me jetën e tij, qofshin personale që lidhen me veten e tij, apo me familjen e tij, apo me ata që kanë lidhje me të, e mos të thellohet në pyetje për çështje imagjinare apo që vështirë se ndodhin.

Vërtetë angazhimi i muslimanit me realitetin, është më e mirë për të sesa të pyesë për çështje imagjinare, edhe nëse ai e perfytyron se mund të ndodhë ajo gjë, sepse prej edukatës së dijetarëve të selefrit radijAllahu anhum, është se kur ndonjërit prej tyre i shfaqej një pyetës që pyeste për ndonjë çështje, dijetari i thoshte atij: “A ka ndodhur?” Nëse përgjigjej: “Po”, atëherë dijetari i jepte përgjigje me dijen që kishte. E nëse thoshte: “Nuk ka ndodhur”, apo “nuk ka ndodhur akoma”, atëherë dijetari i thoshte: “Prit derisa të ndodhë, e pastaj pyet.” Në momentin që ajo çështje të ndodhë,

doemos Allahu azze ue xhel-le do t'i mundësojë një personi që t'i japë përgjigje me dijen e tij.

Për këtë arsye themi se prej edukatës, është që të dëgjojmë pyetjet dhe të fillojmë prej më të rëndësishmes, e më pas t'i japim përgjigje me atë që na e lehtëson Allahu azze ue xhel-le, duke ju kujtuar se jo domosdoshmërisht dijetari duhet të përgjigjet për çdo pyetje që i drejtohet.

Është përcjellë në disa ethere selefije, se: “Kush përgjigjet për çdo pyetje që i drejtohet, ai është budalla”, sepse Allahu i Lartësuar ka thënë:

﴿ وَمَا أُوتِيتُمْ مِنَ الْعِلْمِ إِلَّا قَلِيلًا ﴾

“Dhe ju është dhënë vetëm se pak nga dituria.”⁵¹

Nëse nuk mund t'i japim përgjigje ndonjë pyetjeje, mos të bëjë çudi ndonjëri prej jush, sepse kjo bën pjesë tek natyra që Allahu azze ue xhel-le e ka krijuar njeriun, sikurse e dëgjuat në ajetin e lartpërmendur:

﴿ وَمَا أُوتِيتُمْ مِنَ الْعِلْمِ إِلَّا قَلِيلًا ﴾

“Dhe ju është dhënë vetëm se pak nga dituria.”⁵²

Po ashtu është përcjellë në disa ethere, ku thuhet: “Gjysma e dijes është: nuk e di.”

Përktheu: Besmir Cacani

⁵¹ El Isra' 85.

⁵² El Isra' 85.

BAZA NË TEFSIR
SHEJH MUHAMED EL UTHEJMIN
 (pjesa e katërt)

5- Shkrimi dhe tubimi i Kuranit

Kjo gjë është e bërë e mundur në tre faza:

Faza e parë: në kohën e Pejgamberit sal-lAllahu alejhi ue sel-lem, e kjo kohë ishte më shumë kohë e mbajtjes përmëndësh sesa kohë e të shkruarit; sepse njerëzit shquheshin për memorien e fortë, të mësuarit shumë shpejt dhe për mungesë të lëndës së shkrimit. Për këtë arsye, Kurani nuk u tubua në mus'haf, por kushdo që dëgjonte një ajet, e memorizonte atë përmëndësh, ose e shkruante në ato gjëra që kishin, si gjethet e palmës, lëkurat e kafshëve dhe pllakat e gurit. Gjithashtu numri i sahabëve që e dinin përmëndësh Kuranin ka qenë i madh.

Ka ardhur në sahihun e Buharit,⁵³ nga Enes ibën Malik radijAllahu anhu, se Pejgamberi sal-lAllahu alejhi ue sel-lem dërgoi 70 burra që quheshin “memorizuesit e Kuranit”, të cilëve i doli përpara Hajjani nga fisi Beni Sulejm Ri'l dhe Dhekuan, tek pusi e Maune dhe i vranë. Megjithatë, përsëri mes sahabëve kishte shumë të tjerë (që e dinin Kuranin përmëndësh) si katër halifët, Abdullah ibën Mes'udi, Selimi shërbyesi i Ebu Hudhejfes, Ubej ibën Ka'abi, Muadh ibën Xhebeli, Zejd ibën Thabiti dhe Ebu Derda radijAllahu anhum.

Faza e dytë: në kohën e Ebi Bekrit radijAllahu anhu në vitin 12 hixhri. Shkaku ishte se në luftën e Jemames u vranë shumë prej hafizëve të Kuranit. Njëri prej tyre ishte edhe Selimi shërbyesi i Ebu Hudhejfes, njërit prej atyre që Pejgamberi sal-lAllahu alejhi ue sel-lem e la porosi që merrej Kurani prej tij.

Ebu Bekri radijAllahu anhu, urdhëroi që të tubohej Kurani, që të mos humbiste. Ka ardhur në sahihun e Buhariut,⁵⁴ se Umer ibnul Khatabi i sugjeroi Ebu Bekrit radijAllahu anhum që ta tubonte Kuranin, e kjo pas luftës së Jemames. Ebu Bekri u ndal njëherë duke u ruajtur (mos bëntë gabim), mirëpo Umeri vazhdoi t'ia përsëriste këtë gjë, derisa Allahu ia hapi Ebu Bekrit kraharorin për këtë gjë, kështu që urdhëroi t'ia thërrisnin Zejd

⁵³ Buhariu në kapitullin “Xhahadi”, tema “Ndihma” nr 3064.

⁵⁴ Buhariu në kapitullin “Tefsiri”, në komentimin e ajetit 128 të sures et-Teubeh.

ibën Thabitin, i cili u paraqit dhe Ebu Bekri i tha në prezencë të Umerit: “Ti je i ri dhe i zgjuar. Nuk të akuzojmë dhe je prej atyre që e shkruanin shpalljen që i zbriste të Dërguarit sal-lAllahu alejhi ue sel-lem, kështu që duhet të tubosh Kuranin.” Zejd ibën Thabiti thotë: “Fillova ta tuboja Kuranin nga lëkurat e pemeve, pllakat e gurit apo nga gjokset e burrave. Fletët qëndruan tek Ebu Bekri derisa ai vdiq, pastaj tek Umeri kur ishte gjallë, pastaj tek Hafsa bintu Umer radijAllahu anhum.” E transmeton Buhariu më të zgjatur.

Të gjithë muslimanët e përkrahën Ebu Bekrin dhe i konsiderohet nga të mirat e tij, saqë Aliu radijAllahu anhu ka thënë: “Nga njerëzit që më shumë ka shpërblim për mus’hafet është Ebu Bekri. Allahu e mëshiroftë Ebu Bekrin, ai është i pari që e tuboi Kuranin.”

Faza e tretë: në kohën e prijësit të besimtarëve Uthman ibën Affanit radijAllahu anhu, në vitin 25 hixhri. Shkaku ishte kundërshtia midis njerëzve në leximin e Kuranit në varësi të fletëve që sahabët radijAllahu anhum kishin në duar. Nga frika e fitnes, Uthmani radijAllahu anhu urdhëroi që të mblidhen të gjitha fletët në një mus'haf, që njerëzit mos të kishin mospajtim, e të ndodhë kundërshti midis tyre për Librin e Allahut e të përçahen.

Ka ardhur në sahihun e Buhariut,⁵⁵ se Hudhejfe ibnul Jemani shkoi tek Uthmani, e kjo pasi kishin çliruar Armeninë dhe Azerbajxhanin, sepse ishte frikësuar nga mospajtimi i njerëzve në lexim, andaj tha: “O prijësi i besimtarëve! Shikoje këtë umet, përpara se të përçahen në Kuran siç janë përçarë çifutët dhe të krishterët.” Atëherë Uthmani i dërgoi fjalë Hafsës që të sillte të gjitha fletët me Kuran, në mënyrë që t’i kopjojmë në mus’haf, pastaj do t’i kthejmë përsëri dhe ashtu bëri. Uthmani urdhëroi Zejd ibën Thabitin, Abdullah ibën ez-Zubejrin, Seid ibnul Asin dhe AbduRahman ibnul Harith ibën Hisham të cilët i kopjuan fletët në mus’haf. Zejd ibën Thabiti ka qenë ensarij, kurse tre të tjerët kanë qenë kurejshij. Uthmani i tha tre kurejshëve: “Në qoftë se bini në kundërshtim ju me Zejdin në lidhje me gjuhën, atëherë shkruajeni atë sipas gjuhës së kurejshëve, sepse Kurani ka zbritur në gjuhën e kurejshëve. Këtë gjë e bënë, derisa mbaruan së kopjuari fletët në mus’haf, e pastaj Uthmani ia ktheu fletët Hafsas. Uthmani i shpërndau mus’hafet e bëra në çdo vend dhe, urdhëroi që të digjej çdo fletë apo mus’haf me Kuran që ishte më përpara”.

⁵⁵ Buhariu në kapitullin “Vlerat e Kuranit”, tema “Tubimi i Kuranit” nr 4987.

Uthmani radijAllahu anhu e bëri këtë gjë pasi pyeti sahabët radijAllahu anhum, siç e transmeton Ibën Ebi Daudi⁵⁶ nga Aliu radijAllahu anhu se ka thënë: “Pasha Allahun! Atë e bëri vetëm pasi ishim dakord të gjithë ne”. Uthmani tha: “Mendoj se duhet t’i bashkojmë njerëzit tek një mus’haf, e kështu ska për të patur përçarje dhe mospajtime”. Ne i thamë: “Gjënë më të mirë ke menduar”.

Mus’ab ibën Sad⁵⁷ ka thënë: “Kam arritur njerëz të shumtë që kanë parë kur i ka djegur Uthmani mus’hafët, dhe e kanë pëlqyer këtë gjë”. Ose ka thënë: “Askush nuk e kundërshtoi këtë gjë, e kjo renditet prej veprave të mira që ka bërë prijësi i besimtarëve, Uthmani radijAllahu anhu, të cilën e kanë mbështetur të gjithë muslimanët. Kjo gjë ishte plotësim i asaj që e nisi Ebu Bekri radijAllahu anhu, halifi i Pejgamberit sal-lAllahu alejhi ue sel-lem.

Dallimi midis tubimit të Uthmanit dhe Ebu Bekrit radijAllahu anhum është se, në kohën e Ebu Bekrit është bërë tubim për ta ruajtur të gjithë Kuranin në mus’haf, që të mos humbë gjë prej tij, e jo që njerëzit të bashkohen në një mus’haf të vetëm. Kjo, sepse leximet e ndryshme nuk kishin shfaqur ndonjë ndikim që t’i detyronte të bashkoheshin në një mus’haf të vetëm.

Kurse qëllimi i tubimit në kohën e Uthmanit radijAllahu anhu ishte tubimi i të gjithë Kuranit në një mus’haf të vetëm, që t’i bashkonte njerëzit, për shkak të ndikimit të frikshëm në leximet e ndryshme.

Frytet e këtij tubimi u shfaqën, sepse dobia më e madhe iu kthye umetit, duke u bashkuar, duke e unifikuar fjalën, duke arritur dashurinë, po ashtu u larguar dëmi më i madh, që është përçarja e umetit, mospajtimi, përhapja e urrejtjes dhe armiqësisë.

Kështu vazhdon të jetë deri tani, duke qenë muslimanët në pajtim për këtë gjë dhe mus’hafi është i disponueshëm, ku të vegjëlit e mësojnë nga të mëdhenjtë. Asnjë dorë dashakeqe nuk e ka cënuar, asnjë ëndje e devijuar nuk e ka fshehur, andaj lavdi Allahut, Zotit të qiejve, të tokës dhe Zotit të krijesave.

...vijon në numrin e ardhshëm inshaAllah...

Përktheu: Idriz Manushi

⁵⁶ Transmeton Hatibi në “el Faslu lil uaslil mudraxh” 2/954 dhe në zinxhirin e transmetimit gjendet Muhamed ibën Eban el Xha’fij, (Ilel i Darakutnit 3/229-230). Ibën Ma’ini ka thënë: “I dobët”. El Xherhu uet-ta’dil i Razit 7/200.

⁵⁷ Transmeton Ibën Ebi Daudi në librin “el Masahif” fq 12.

DISPOZITAT QË LIDHEN ME MENSTRUACIONET DHE LEHONINË

SHEJH MUHAMED EL UTHEJMIN

Pyetja 81: shejh i nderuar! Cilat janë dispozitat që lidhen me menstruacionet dhe lehoninë?

Përgjigjja: dijetarët kanë thënë për menstruacionet se: është gjak natyral dhe natyrshmëri e zakonit tek femra e cila mund të mbesë shtatzënë në ditë të mirënjohura. Gjithashtu kanë thënë: me të vërtetë Allahu azze ue xhel-le i ka krijuar (menstruacionet) për ushqyerjen e foshnjes në barkun e nënës së saj, e për këtë arsye, kur gruaja mbet shtatzënë, menstruacionet i ndalen zakonisht.

Nëse gruas i vjen gjaku natyral i menstruacioneve, atëherë me të lidhen shumë dispozita, ku prej tyre:

Ndalohet namazi dhe agjërimi, sepse Pejgamberi sal-lAllahu alejhi ue sel-lem ka thënë: **“A nuk është gruaja që kur i vijnë menstruacionet, nuk fal namaz dhe nuk agjëron?”**⁵⁸ Andaj, gruas nuk i lejohet që të agjërojë apo të falet gjatë kohës që është me menstruacione. Nëse ajo i bën këto të fundit, atëherë ka bërë gjynah dhe i ka të papranuara agjërimin dhe namazin.

Së dyti: gruas (me menstruacione) i ndalohet tavafi rreth Qabes, sepse Pejgamberi sal-lAllahu alejhi ue sel-lem i ka thënë Aishes kur i patën ardhur menstruacionet: **“Bëj çfarë bën haxhiu, përveç tavafit rreth Qabes.”**⁵⁹ Kur iu përmend Pejgamberit sal-lAllahu alejhi ue sel-lem se Safije bintu Hujej i kishin ardhur menstruacionet, ai tha: **“A do të na ndalojë ajo (nga udhëtimi)?”** Kjo, sepse mendoj se Safija nuk e kishte bërë tavafin e lamtumirës, kështu që i thanë se e kishte bërë tavafin e lamtumirës, ndërsa ai tha: **“Dilni!”**⁶⁰ Nga ky hadith mësojmë se nëse gruaja bën tavafin e lamtumirës që është edhe tavafi i haxhit, e pastaj i vijnë menstruacionet, atëherë ritualet e saja janë plotësuar, edhe sikur menstruacionet t’i vijnë pas tavafit të lamtumirës dhe para Sa’jit, ritualet e saja janë plotësuar, sepse Sa’ji është i saktë nëse bëhet nga gruaja me menstruacione.

⁵⁸ Transmeton Buhariu, kitabul hajd, babu terkil haid es-saum 304.

⁵⁹ Transmeton Buhariu, kitabul hajd, babu tekdil hajdul menasike kul-lehe il-la et-tauafe bil bejt 305, Muslimi, kitabul haxh, babu vuxhul ihram, 1211.

⁶⁰ Transmeton Buhariu, kitabul haxh, babu ez-zijarati jeum en-nahr 1733, Muslimi kitabul haxh, babu vuxhubu tauaful uedea’ ue sukutuhu anil haid 1211.

Nga ky hadith, gjithashtu mësojmë se bie obligimi i tavafit të lamtumirës për gruan me menstruancione, siç ka ardhur në formë të drejtpëdrejtë në hadithin e Abdullah ibën Abasit, radijAllahu anhume se ka thënë: “Njerëzit janë urdhëruar që gjëja e fundit që bëjnë të jetë tavafi rreth Qabes, mirëpo është bërë lehtësim për gruan me menstruacione.”⁶¹

Gruaja me menstruacione e ka të ndaluar gjithashtu që të kryejë marrëdhënie seksuale, sepse Allahu i Lartësuar thotë:

﴿وَيَسْأَلُونَكَ عَنِ الْمَحِيضِ قُلْ هُوَ أَذَى فَأَعْتَزِلُوا النِّسَاءَ فِي الْمَحِيضِ وَلَا تَقْرُبُوهُنَّ حَتَّىٰ يَطْهُرْنَ فَإِذَا تَطَهَّرْنَ فَأْتُوهُنَّ

مِنْ حَيْثُ أَمَرَ اللَّهُ ۗ البقرة: ٢٢٢

“Të pyesin ty (Muhamed) për të përmuajshmet e femrave. Thuaju: “Ajo është gjendje e dëmshme.” Prandaj, gjatë kësaj kohe, mos iu afroni atyre (për marrëdhënie) derisa të pastrohen. Pasi të pastrohen, atëherë afrohuni tek ato ashtu si ju ka urdhëruar Allahu.”⁶² Ajeti fisnik tregon se njeriu e ka të ndaluar që të kryejë marrëdhënie me gruan e tij kur ajo është me menstruacione, mirëpo kur t’i kalojnë menstruacionet, nuk duhet të kryejë marrëdhënie pa u pastruar, sepse ka thënë:

“Pasi të pastrohen” d.m.th. pasi të lahen (marrin gusël), sepse me pastrim është për qëllim larja (marrja gusël).

Allahu i Lartësuar thotë:

﴿وَإِنْ كُنْتُمْ جُنُبًا فَاطَّهَّرُوا ۗ المائدة: ٦

“Nëse jeni të papastër (si pasojë e marrëdhënieve bashkëshortore apo e derdhjes së spermës), pastrohuni (duke u larë krejtësisht)!”⁶³

Mirëpo, njeriu e ka të lejuara puthë dhe përkëdhelë gruan kur është me menstruacione, po ashtu të kënaqet me të, përveçse në organin e saj gjenital. Kjo gjë e lehtëson epshin e njeriut që nuk mund të përmbahet nga gruaja e tij gjatë kohës së menstruacioneve. Ai mund të kënaqet me gruan, përveçse të kryejë marrëdhënie seksuale. Sa i përket marrëdhënive në anus, atëherë kjo gjë është e ndaluar në çfarë do rasti, edhe kur gruaja është me menstruacione edhe kur nuk është me to.

⁶¹ Transmeton Buhariu, kitabul haxh, babu tauafil uedea 1755, Muslimi kitabul haxh, babu vuxhubu tauaful uedea’ ue sukutuhu anil haid 1328.

⁶² El Bekare 222.

⁶³ El Maideh: 6.

Prej dispozitave që lidhen me menstruacionet: se kur gruas i ikin menstruacionet në kohë namazi, atëherë ajo duhet të shpejtojë të lahet, që të falë namazin para daljes së kohës. P.sh. nëse i ikin pasi ka hyrë koha e namazit të sabahut dhe Dielli nuk ka lindur akoma, atëherë duhet të lahet që të falë namazin e sabahut në kohë të tij. Disa gra tregohen të shkujdesura lidhur me këtë çështje, sepse i ikin menstruacionet, mirëpo në ditët e dimrit e shtyjnë dhe shkujdesen ndaj namazit, derisa koha del. Kjo e fundit është haram dhe nuk i lejohet ta bëjë, mirëpo e ka për detyrë që të lahet dhe ta falë namazin në kohën e tij.

Kohët e namazit janë të njohura për njerëzit: sabahu që fillon me daljen e dritës derisa të lindë Dielli, koha e drekës që fillon me mesditën derisa të bëhet hija sa gjatësia e objektit, koha e iqindisë që fillon me përfundimin e drekës derisa të zverdhet Dielli – kjo është koha e zgjedhjes – ose deri kur të perëndojë Dielli – kjo është koha e nevojës –, koha e akshamit që është nga perëndimi i Diellit deri në kohën e horizontit të kuq, ndërsa jacia nga zhdukja e horizontit të kuq deri në mesnatë. Pas mesnate nuk është kohë që falet jacia, sepse ka dalur koha e saj, përveç rastit kur njeriu ka qenë në gjumë apo ka harruar, sepse Pejgamberi sal-lAllahu alejhi ue sel-lem ka thënë: **“Kush fle ndaj një namazi apo e harron, atëherë le ta falë kur t’i kujtohet.”**⁶⁴

Le të dihet se gjaku i gruas që është në moshë të pjekurisë, në origjinë është gjak i menstruacioneve, derisa të vijë argumenti që e nxjerr nga kjo origjinë. Ajo që e nxjerr nga kjo origjinë është të dihet se ky gjak ka dalë nga ndonjë damar dhe nuk është gjak i menstruacioneve, si p.sh. kur del gjak pas një operacioni të bërë, apo nga një frikë që e godet, apo të tjera shkaqe që sjellin rrjedhje gjaku që nuk janë menstruacione. Në këto raste gjaku nuk konsiderohet gjak menstruacionesh. Po ashtu, nëse gjaku është i shumtë dhe rrjedh në pjesën më të madhe të muajit, atëherë në këtë rast është gjak istihada, kështu që gruaja i kthehet të zakonshmes para se t’i ndodhë istihada; rri⁶⁵ si zakonisht, pastaj lahet dhe falet, edhe nëse rrjedhja e gjakut vazhdon.

Prej dispozitave që lidhen me menstruacionet dhe lehoninë: se burrit nuk i lejohet ta divorcojë gruan e tij kur është me menstruacione, e nëse e bën këtë gjë, ka bërë gjynah, kështu që duhet ta kthejë gruan tek vetja

⁶⁴ Transmeton Buhariu, kitabul mauakit es-salat, babu men nesije salaten fel jusal-li idhe dheker 597, Muslimi kitabul mesaxhid, babu kadau es-salatil feiteh 684, teksti është i Muslimit.

⁶⁵ Pa namaz dhe agjërime. (shp)

e tij, në mënyrë që ta divorcojë në gjendje pastërtie dhe pa kryer marrëdhënie seksuale. Kjo, sepse është vërtetuar në dy sahihët, nga hadithi i Abdullah ibën Umerit radijAllahu anhume se ka divorcuar gruan e tij gjatë kohës së menstruacioneve dhe Umeri ia tregoi këtë gjë Pejgamberit sal-lAllahu alejhi ue sel-lem, i cili u zemëruar me të, pastaj tha: **“Urdhëroje që ta kthejë, pastaj ta divorcojë në gjendje pastërtie, apo shtatzanie.”**⁶⁶

Shumë njerëz – Allahu na udhëzofte ne dhe ata – nguten në këtë çështje dhe e divorcojnë gruan në gjendje menstruacionesh, apo e divorcojnë në kohë pastërtie që ka kryer marrëdhënie seksuale me të dhe para se të bëhet e qartë nëse është shtatzënë apo jo. Të gjitha këto janë haram dhe burri duhet të pendohet tek Allahu nga to, po ashtu duhet ta kthejë gruan që e ka divorcuar në tillë gjendje.

Prej dispozitave që lidhen me menstruacionet dhe lehoninë: nëse gruas së lehonë i kalon lehonja para dyzet ditëve, atëherë ajo e ka për detyrë që të lahet, të falet dhe të agjërojë nëse është muaji i Ramazanit, sepse kur gruas i kalon lehonja, edhe nëse është brënda dyzet ditëve, ajo merr gjykimin e grave të pastërta. Kjo vlen edhe për marrëdhëniet seksuale, ku burrit të saj i lejohet të kryejë marrëdhënie edhe pse nuk janë mbushur dyzet ditë, sepse kur bëhet i lejuar namazi, atëherë në mënyrë më parësore bëhen të lejuara marrëdhëniet seksuale.

Prej dispozitave që lidhen me menstruacionet dhe lehoninë: siç aludua më lart është detyrë për gruan me menstruacione dhe me lehonë që të lahen pasi të ikin ato. Dispozitat e menstruacioneve dhe lehonisë janë të shumta dhe ne po mjaftohemi me këtë masë, mbase është e mjaftueshme inshaAllah.

RASTI KUR GRUAJA NUK KA RRJEDHJE GJAKU

Pyetja 82: shejh i nderuar, lidhur me rastin kur gruaja nuk ka rrjedhje gjaku lehonie, a konsiderohet ajo si e lehonë?

Përgjigjja: nëse ajo nuk ka rrjedhje gjaku lehonie, atëherë nuk konsiderohet e lehonë, nuk është e detyruar të bëjë diçka, nuk është e detyruar të lahet, nuk e ka të ndaluar as namazin dhe as agjërimin.

⁶⁶ Trasmeton Muslimi, kitabu et-talak, babu tahrim el haid bigarji ridahe 1471.

GJYKIMI I MARRJES SË KAPSULAVE QË NDALOJNË MENSTRUACIONET GJATË KRYERJES SË HAXHIT

Pyetja 83: shejh i nderuar, a i lejohet gruas të marrë kapsula që ndalojnë menstruacionet, e kjo gjatë kryerjes së haxhit, në mënyrë që ta ketë të mundur kryerjen a tij? Si p.sh. kapsula që pengojnë shtatzaninë, apo çfarëdo lloj gjëje që mund të përdoret?

Përgjigjja: në origjinë, kjo gjë lejohet dhe gruas i lejohet të marrë diçka që i pengon menstruacionet, nëse e bën me leje të burrit të saj. Mirëpo, më kanë treguar disa mjekë, se këto kapsula që pengojnë menstruacionet janë shumë të dëmshme për gruan; të dëmshme për mitrën, për nervat, për gjakun etj. Madje disa mjekë më kanë thënë se po t'i përdorë vajza e virgjër, atëherë bëhen shkak për sterilitetin e saj, e kjo gjë është rrezik i madh. Kjo që thonë disa mjekë, nuk është gjë e largët, sepse gjaku i menstruacioneve është gjak natyral, e nëse njeriu përpiqet ta ndalë me këto kapsula, atëherë po përpiqet të kundërshtojë natyrshmërinë. Pa dyshim që kundërshtimi i natyrshmërisë është diçka shumë e dëmshme, sepse sjell bllokimin e gjakut nga koha e daljes së tij, që është edhe nga natyra e gruas. Për këtë arsye, i këshilloj të gjitha gratë tona lidhur me këtë çështje, që ta lejnë përdorimin e këtyre kapsulave gjatë Ramazanit dhe jashta Ramazanit.

Mirëpo, sa i përket haxhit dhe umres, mbase nevoja apo domosdoshmëria kërkojnë që t'i përdorësh këto kapsula. Ky përdorim është i përkohshëm, e mbase gruaja nuk i përdor më gjatë gjithë jetës së saj. Në këtë rast shpresoj mos të ketë as problem dhe as dëm.

NËSE VËRTETOHET DËMI I KAPSULAVE, ÇFARË GJYKIMI KANË ATO?

Pyetja 84: shejh i nderuar, mirëpo nëse vërtetohet dëmi i kapsulave, çfarë gjykimi kanë ato?

Përgjigjja: nëse vërtetohet dëmi i kapsulave, atëherë është e ditur se njeriut nuk i lejohet përdorimi i gjërave që është vërtetuar dëmi i tyre, sepse Allahu azze ue xhel-le thotë:

﴿وَلَا تَقْتُلُوا أَنْفُسَكُمْ إِنَّ اللَّهَ كَانَ بِكُمْ رَحِيمًا﴾ النساء: ٢٩

“Dhe mos e vritni veten (dhe njëri-tjetrin)! Vërtet, Allahu është i Mëshirshëm me ju.”⁶⁷ Amër ibnul Asi është argumentuar me këtë ajet në momentin që Pejgamberi sal-lAllahu alejhi ue sel-lem i tha: **“A u fale me**

⁶⁷ En-Nisa' 29.

shokët tuaj duke qenë xhunub?” Amri radijAllahu anhu ishte bërë xhunub në një natë të ftohtë, andaj mori tejemum dhe u fal me shokët e tij. Kur Pejgamberi sal-lAllahu alejhi ue sel-lem i tha: **“A u fale me shokët tuaj duke qenë xhunub?”** Amri tha: “O i Dërguari i Allahut! Mu kujtua fjala e Allahut të Lartësuar:

﴿وَلَا تَقْتُلُوا أَنْفُسَكُمْ إِنَّ اللَّهَ كَانَ بِكُمْ رَحِيمًا﴾ النساء: ٢٩

“Dhe mos e vritni veten (dhe njëri-tjetrin)! **Vërtet, Allahu është i Mëshirshëm me ju.**”⁶⁸ Kështu që Pejgamberi sal-lAllahu alejhi buzëqeshi apo qeshi dhe e miratoi Amrin.⁶⁹ Kjo tregon se çdo gjë që përbën dëm për trupin e njeriut, nuk është e lejuar të konsumohet (ta bëhet).

Përktheu: Besmir Cacani

⁶⁸ En-Nisa' 29.

⁶⁹ Transmeton Ebu Daudi, kitabu et-taharati, babu idhe khafel xhunubu el berde e jetejemmemu 334.

CILËSITË DALLUESE TË HADADIVE

SHEJH RABI' EL MEDKHALI

Me emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit

Lavdi Allahut, salavatet dhe selamet qofshin mbi të Dërguarin e Allahut, familjen e tij, shokët e tij dhe ata që e pasojnë.

Më pas:

Për shkak të fitnes që ka ndodhur mes të rinjve në Jemen, e cilat është zgjatur dhe përhapur derisa ka kaluar edhe në vende të tjera, shumë njerëz filluan të kërkojnë sqarimin e të vërtetës; kush është në të vërtetën, e kush në të gabuarën. Shkak i kësaj fitneje është se nxënësit e dijes në Jemen filluan të akuzojnë njëri-tjetrin për hadadi, andaj u detyrova ta sqaroj këtë menhexh, ndoshta kjo i sqaron nxënësit që dëshirojnë të vërtetën sesi të dallojnë mes menhexhit të Ehli Sunetit dhe atij hadadi.

Gjithashtu, kjo mbase ndihmon një farë mënyre që të shuhet kjo fitne, dhe premtojmë se do të vazhdojmë të sqarojmë edhe çështjet e tjera, duke iu përgjigjur kërkesave të vazhdueshme dhe përpjekur për t'i dhënë fund kësaj fitneje.

MENHEXHI I HADADIVE

1- Ata i urrejnë dijetarët bashkëkohor të menhexhit Selefi, i nënçmojnë, i konsiderojnë injoranta, të devijuar dhe shpifin ndaj tyre, sidomos ndaj dijetarëve të Medines. Më pas, kaluan deri tek Ibën Tejmija, Ibën Kajimi dhe Ibën Ebil Izzi, komentuesit të "Tahavijes". Hadaditë murmurojnë rreth tyre me qëllim që t'ia ulin pozitën dhe t'ia refuzojnë fjalët.

2- Ata bëjnë bidatçi çdo person që bie në bidat. Sipas tyre, Ibën Haxheri është më i keq dhe më i rrezikshëm se Sejid Kutubi.

3- Ata bëjnë bidatçi secilin që nuk e bën bidatçi personin që ka rënë në bidat, e armiqësojnë dhe e luftojnë. Për ta nuk mjafton të thuash: "Filani ka esharizëm" apo të thuash "eshari", mirëpo duhet patjetër të thuash "bidatçi", përndryshe të luftojnë, të bojkotojnë dhe të bëjnë bidatçi.

4- E bëjnë të ndaluar që të biesh rahmet ndaj bidatçive në mënyrë të pakushtëzuar. Sipas tyre, nuk ka dallim mes rafidiut, kaderiut, xhehmiut dhe mes një dijetari që ka rënë në një bidat.

5- E bëjnë bidatçi personin që bie rahmet për Ebu Hanifen, Sheukanin, Ibnul Xheuzin, Ibën Haxherin dhe Neveviun.

6- Armiqësojnë shumë ashpër selefitë, sado që të kenë kontribut në thirrjen Selefije dhe në mbrojtje të saj, sado të përpiqen në luftën ndaj bidatit, hizbijes dhe devijimeve. Ata përqendrohen [në luftë kundër] dijetarëve të Medines, pastaj kundër shejh Albanit Allahu e mëshiroftë, sepse është prej dijetarëve të mëdhenj të menexhit Selefi, d.m.th. është prej dijetarëve më të ashpër në “shtypjen” e hizbive, bidatçive dhe fanatikëve. Njëri prej tyre e ka përgënjeshtuar Ibën Utthejminin në tubimin tim më shumë se dhjetë herë, andaj u zemërova shumë me të dhe e dëbova nga tubimi. Ata kanë shkruar libra për këtë gjë dhe kanë përhapur kasete. Ata kanë përhapur propaganda kundër dijetarëve, i kanë mbushur librat, kasetat dhe propagandat e tyre me gënjeshtër dhe shpifje ndaj dijetarëve. Prej padrejtësive të Hadadit është se ka shkruar një libër në akuzë dhe prishje të imazhit të shejh Albanit, rreth katër qindë faqe me shkrim dore. Nëse botohet, mbase dalin një mijë faqe dhe e ka quajtur “el Khamis”, që do të thotë “ushtria e madhe” e përbërë nga ballorja, fundorja, mesi, pjesa e djathtë dhe ajo e majtë. Ai pretendonte se paralajmëronte nga Ikhuhanul Musliminët, nga Sejid Kutubi dhe Xhuhejmanitë, mirëpo nuk kemi parë se ka shkruar diçka për ta; asnjë libërth të vogël [kundër tyre], e jo më një libër sikur “el Khamis”.

7- Ata e teprojnë me Hadadin dhe pretendojnë se është superior në dituri, në mënyrë që të vazhdojnë të hedhin poshtë dijetarët e mëdhenj dhe menhexhin Selefi. Ata i japin shejhut të tyre pozitën e imamit të padiskutueshëm, siç bëjnë pasuesit e atij që është goditur me çmendurinë e pozitës. Kanë thënë për filan dhe filan dijetar të madh: “Duhet të shkojnë të kërkojnë diturinë tek Ebu Abdullah el Hadadi dhe Ummu Abdullahi (gruaja e tij)”.

8- I lëshohen dijetarëve Selefi në Medine dhe të tjerëve duke i akuzuar për gënjeshtarë: filani është gënjeshtar, filani është gënjeshtar. Ata shfaqen me pamjen se e duan besnikërinë dhe përpiqen të jenë të tillë, e kur iu sqarua gënjeshtër e Hadadit me argumente dhe prova, atëherë Allahu e tregoi realitetin e tyre dhe çfarë poshtërsishë fshihnin, duke e shtuar përngjasimin me Hadadin dhe teprimin lidhur me të.

9- Dallohen me mallkim, ftohtësi me njerëzit dhe ekstremizëm, saqë i kanë kërcënuar selefitë se do t’i rrihnin, madje i kanë rrahur disa selefi.

10- Mallkojnë njerëz specifik, saqë disa e mallkojnë Ebu Hanifen, e disa të tjerë i bëjnë tekfir. Hadadi e shikon një fjalë të saktë apo të gabuar, pastaj e cilëson atë si “jofetari”, gjë e cila të lë të kuptosh se është një tekfiris i fshehur.

11- Mendjemadhësia dhe kokëfortësia që të shpien në refuzimin e të vërtetës, ashtu sikur bidatçitë ekstremë. Çdo gjë që dijetarët e Medines e paraqitën në sqarim të devijimeve të Hadadit nga menhexhi Selefii, ata e refuzuan. Me këto vepra të tyre, ata janë grupacioni më i poshtër dhe më i keq nga sjellja dhe hizbija.

12- Më së shumti i mvisheshin imam Ahmedit, e kur iu sqarua sesi Hadadi e kundërshtonte imam Ahmedin në qëndrimin ndaj bidatçive, e mohuan dhe e akuzuan personin që ia përkatësonte imam Ahmedit atë gjë. Hadadi ka thënë: “Nëse është e saktë kjo gjë nga imam Ahmedi, atëherë ne nuk e pasojmë”. Ata nuk e duan të vërtetën, as që e kërkojnë, mirëpo synojnë të bëjnë fitne dhe të përçajnë selefite. Me gjithë këtë ekstrem të tyre, selefite kanë parë tek disa prej tyre lidhje me hizbite, e disa të tjerë lidhje me njerëzit e prishur gjatë kohës që i luftonin selefite dhe i urrenin në formën më të ashpër. Hadaditë mbase fshehin shumë të këqija. Allahu e di më mirë se çfarë fshehin.

Nëse Ebul Haseni na e sqaron me argumente të qarta, se njerëzit që i ka akuzuar për hadadi cilësohen me këto cilësi, atëherë edhe ne do t'i gjykojmë si hadadi, madje do t'i qortojmë me shkrime, do të paralajmërojmë prej tyre dhe do t'i bashkangjesim me hadaditë pa përdëllim.

Nëse nuk është në gjendje ta bëjë këtë, atëherë duhet të pendohet tek Allahu azze ue xhel-le dhe ta bëjë publike këtë pendim, përndryshe nuk do të mungojë ndihma ynë për ta dhe për menhexhin Selefii në të cilin ecin; do të mbrojmë menhexhin dhe ata.

Selefite besnikë duhet t'i ndihmojnë ata dhe menhexhin në të cilin ecin. Ata duhet të ndalojnë ata që i kanë bërë padrejtësi dhe i kanë bërë padrejtësi menhexhit të tyre. Ruhuni nga rënia e ndonjërit prej tyre në gabimet e hadadive, apo në disa gabime të tyre. Kjo është mënyra praktike për të dalluar besnikët nga gënjeshtarët, siç ka thënë Allahu i Lartësuar:

أَحْسِبَ النَّاسُ أَنْ يُتْرَكُوا أَنْ يَقُولُوا آمَنَّا وَهُمْ لَا يُفْتَنُونَ (2) وَلَقَدْ فَتَنَّا الَّذِينَ مِنْ قَبْلِهِمْ فَلَيَعْلَمَنَّ اللَّهُ الَّذِينَ صَدَقُوا وَلَيَعْلَمَنَّ الْكَاذِبِينَ

“Vërtet mendojnë njerëzit, se do të lihen të thonë “Ne besojmë”, pa u vënë në provë?! Ne i kemi sprovuar ata që kanë qenë para tyre, në mënyrë që, Allahu të dallojë ata, që thonë të vërtetën dhe, ata që gënjejnë”.⁷⁰

⁷⁰ El Ankebut 2-3.

E lus Allahun Bujar, Zotin e Arshit madhështor, që t'i mbrojë të gjithë selefite në çdo vend që janë, nga rënia në këtë sprovë, e veçanërisht ata në Jemen, atje ku është shfaqur Suneti i Pejgamberit sal-Allahu alejhi ue sellem përmes menhexhit Selefi.

Shkroi

Rabi' ibën Hadi el Medkhali

20/2/1422 h⁷¹

Përktheu: Besmir Cacani

⁷¹ D.m.th. është shkruar para 20 vitesh. (shp)

DALLIMI MIDIS HADADIZMIT DHE SELEFIZMIT

SHEJH RABI' EL MEDKHALI

Pyetja: cili është dallimi midis Hadadizmit dhe Selefizmit? Si mund të bëjmë dallim mes tyre?

Përgjigja: dallimi midis tyre është se hadaditë i ka udhëhequr një njeri epsharak, që ka patur smirë, urrejtje dhe nënçmim për dijetarët. Jeta e tij – kur ishte në Egjipt dhe pa ardhur në Arabinë Saudite – njihet për akuzat dhe prishjen e imazhit të dijetarëve.

Kur erdhi në Rijad dhe qëndroi 7 vjet, ai nuk takoi as shejh Ibën Bazin, as Feuzanin, as Tuvejxhirin dhe askënd prej dijetarëve të Sunetit. Ai madje as që mori diturinë prej tyre, për shkak të mllefrit të madh që kishte, mendjemadhësisë dhe kryelartësisë. Më pas, kur erdhi në Medine për qëllime të caktuara – që ishte nxitja e fitneve – erdhi si i kapur për fe, si i butë dhe i fshehur, deri kur mori tezkije nga dijetarët e Medines, e më pas filloi të grumbullonte mendjelehtët rreth tij. Pas një kohe, dijetarët e Medines kuptuan se po i kundërviheshin atyre dhe dijetarëve të tjerë të Arabisë Saudite, dijetarëve të Sunetit në çdo vend dhe jo vetëm në Arabinë Saudite; në çdo vend, madje edhe ndaj XhemilurRahmanit nxorën akuza pas vdekjes së tij, Allahu e mëshiroftë, shpresojmë që të jetë prej shehidëve.

Ata janë kryengritje ndaj Ehli Sunetit dhe menhexhit të tyre. Ne i kemi këshilluar. Pasha Allahun i kam këshilluar, jam sjellur butë me ta, i kam dialoguar me edukatë duke shpresuar që të kthehen nga ajo rrugë – sepse nuk duam fitne pasha Allahun – mirëpo kundërshtuan dhe zgjodhën kryengritjen, fitnen dhe nisën që t'i akuzojnë dijetarët e Ehli Sunetit me fjalë të këqija si: ky është gënjeshtar, ky është i poshtër, ky kështu, e ky ashtu. Ata akuzuan Ibën Haxherin dhe Sheukanin duke e bërë rrugë për hedhjen e tyre poshtë. Ata i angazhuan selefite me një angazhim të pa parë ndonjëherë.

Njëri prej selefive u nis për t'i debatuar dhe analizuar disa shkrime të Hadadit, mirëpo ai solli kaseta dhe libra, pastaj filloi të prishte librat e Ehli Sunetit, t'i nënçmonte, t'i luftonte dhe të hidhte akuza ndaj atyre.

Një djalosh, u ngrit dhe iu kundërpërgjigj Hadadit, e kjo kur ai akuzoi shejh Muhamed Eman (el Xhamin), shejh Salih es-Suhejmin, shejh Muhamed ibën Rabinë, shejh Rabi' ibën Hadin dhe tha se shejh Rabi' e kishte shkruar atë libër. Hadadi gënjeshtar betohej për Allahun se Rabi' e ka shkruar librin!

Prej shenjave dalluese të tyre janë: gënjeshtria, padrejtësia, urrejtja e dijetarëve, përpjekja për t'i rrëzuar dijetarët, mëndjemadhësia dhe zhvlerësimi i dijetarëve. Disa prej tyre kanë thënë: “Filani dhe filani prej dijetarëve të mëdhenj, duhet të shkojmë tek gruaja e Hadadit dhe të ulen që të mësojnë tek ajo”. Kështu i nënçmonin dijetarët dhe i akuzonin me injorancë.

Andaj, kush i ka këto cilësi, atëherë ai është hadadi, pra ai që sulmon dhe akuzon dijetarët duke dashur t'i hedhë poshtë ata sipas metodës që përmenda, atëherë ai është hadadi.

Vazhdonin të gënjenin, të akuzonin e të akuzonin, andaj i sqaruar gënjeshttrat e shejhut të tyre, gabimet dhe devijimet e tija, mirëpo kjo ia shtoi atyre ekstremizmin. Të gjithë ata që i përngjasojnë atyre, kalon në teprim ndaj njerëzve, i refuzon argumentet e qarta dhe akuzon Ehli Sunetin, atëherë ai është hadadi, madje edhe më keq se hadaditë.

Tani është një grup në internet që ndjek metodën e hadadive. Në internet është një grup që e cilësojnë Ehli Sunetin se janë hadadi, ndërkohë që cilësitë e hadadive gjenden pikërisht tek ta, sikur: teprimi (ekstremi), gënjeshtria dhe refuzimi i të vërtetës, pra, e njëjta metodë e hadadive. Kuptojeni këtë gjë, mësojini mirë cilësitë e hadadive dhe këdo që e shikon me këto cilësi, le ta dini se ai është prej hadadive, ose i përngjason atyre, ose është edhe më keq se ata.

Besimtari duhet të respektojë fenë e tij, logjikën e tij, të respektojë këtë menhexh dhe po ashtu përkatësimin tek Selefizmi. Ai nuk duhet ta lërë logjikën e tij në duart e mendjelehtëve, sepse do lodrojnë me të, me fenë dhe me besimin e tij.

Besimtari nuk ia dorëzon fenë e tij askujt, kushdo qoftë ai. Jo pasha Allahun, askujt nuk ia dorëzon fenë, sado i madh të jetë ai, përveç të Dërguarit sal-lAllahu alejhi ue sel-lem. Askujt nuk ia dorëzon fenë, sepse bindja e plotë është vetëm për Allahun, dashuria e plotë është vetëm për Allahun, të Dërguarin e Tij dhe për sahabët e tij të nderuar. Kjo, sepse e vërteta sillet nga është i Dërguari sal-lAllahu alejhi ue sel-lem, po ashtu edhe sahabët; e vërteta sillet nga janë ata. Kurse për të tjerët nuk është kështu, sepse ata ia qëllojnë, por edhe gabojnë.

Teprimi (ekstremi) në fenë e Allahut është prej cilësive më të urryera, po ashtu dhe teprimi me njerëzit është prej cilësive më të urryera. I Dërguari i Allahut sal-lAllahu alejhi ue sel-lem ka thënë: **“Mos e teproni me mua siç bënë të krishterët me Isain, birin e Merjemes”**. Nëse i Dërguari i Allahut

sal-lAllahu alejhi ue sel-lem nuk e lejon që të teprohet me të, si mund të teprohet me njerëz të ultë, Allahu na ruajtë. E fryjnë personin e ultë duke e bërë gjigand, kolos etj. Kjo është gënjeshtër ndaj Allahut, është teprim me njerëzit, është teprim në fe, Allahu na ruajtë dhe na mbroftë prej këtyre cilësive.

Të tillë janë hadaditë në raport me teprimin me Hadadin; e ngritën ndërkohë që është vetëm një injorant, një dështak i padrejtë.

Më besoni o vëllezër! Thotë se ka 20 vjet që paralajmëron nga Ikhuanal Muslimët, nga Sejid Kutub etj, mirëpo nuk dimë ndonjë libër apo ndonjë kasetë në luftën kundra tyre, e sapo e “prekën” selefitë, iu lëshua si luan për të shkruar dhe përhapur kasete. Hadadi shkroi kundra Albanit një libër me 400 faqe, të mbushur me gënjeshtër dhe padrejtësi, duke e quajtur “el Khamis”⁷²; ballorja, pjesa mbrapa, e djathta, e majta dhe mesi!!

Në rregull, pse nuk ia lëshove këtë ushtri rafidive, pse nuk ia lëshove këtë ushtri Ikhuanal Musliminëve!? Ti thua se ke paralajmëruar prej tyre që para 20 vjetësh, pse nuk e drejton këtë ushtri të madhe kundër tyre!? Mirëpo ia drejton Albanit që është imami i Sunetit?!

Tani ka një sulm të ashpër. Albani nuk është më prezent, mirëpo tani sulmi i është drejtuar [dijetarëve] të tjerë. Këto janë cilësitë e Hadadive.

Tani është një grup – ata në internet – dhe janë sulur, kanë ushtri sikur ajo e Hadadit. Ata sulen me libra, me kasete dhe me fjalë, ndërkohë që Ehli Sunetin e quajnë hadadi. Ma hodhi fajin dhe iku!

Ne i këshillojmë ata që të pendohen tek Allahu, të dorëzohen tek Ai, të nënshtrohen para Allahut, ta respektojnë këtë menhexh (menhexhin Selefii), të respektojnë mendjet e tyre, vetet e tyre, përndryshe do të kemi një fatkeqësi të re dhe më të keqe se ajo e Hadadive.

Gjithashtu prej cilësive të tyre është mos rënia rahmet. Nëse ti bie rahmet për Ibën Haxherin, Sheukanin dhe Neveviun, ata thonë: “Ti je bidatçi!” Nëse thua hafizi i hadithit, ata thonë: “Ti je bidatçi!” Nëse thua kanë Esharizëm, ata thonë: “Patjetër duhet të thuash se janë bidatçi, e nëse nuk e thua, atëherë edhe ti je bidatçi”.

⁷² Me këtë fjalë, në gjuhën arabe kihet për qëllim ushtria e madhe. Pra, Hadadi librin e tij e ka krahasuar me një ushtri të madhe që e ka lëshuar kundër shejh Albanit, Allahu e mëshiroftë. (shp)

I kemi thënë: Nëse themi Esharij, kjo do të thotë se ka bidate, njeriu duhet të flasë me edukatë, jo patjetër duhet të thotë se është bidatçi.

Unë ju lexoj juve disa biografi të shkruara nga Buhariu, ai përmend Xhabir el Xha'fij apo të tjerë, mirëpo nuk thotë për ta bidatçi. Buhari e di që ai është rafidi dhe përsëri nuk i thotë bidatçi, sepse kjo nuk është e domosdoshme. Ti sqaroje gabimin e tij, si këshillë për njerëzit, mirëpo nuk është e domosdoshme të thuash ai është bidatçi, apo dikush tjetër është bidatçi. Hadaditë përsëri refuzuan.

Më kanë telefonuar njëherë disa njerëz nga qyteti Ebha dhe më thanë: “Çfarë thua për Ibën Haxherin?” I them: “Ka Esharizëm”. Ai më thotë mua: “Jo, ti je i devijuar, duhet patjetër të thuash bidatçi”.

Kanë edhe gjëra të tjera, por nuk më kujtohen. Kush do t'i përngjasojë, do t'ia tregojmë cilat janë cilësitë e tyre, kush janë hadaditë, cilat janë parimet dhe qëllimet e tyre. Do t'i sqarojmë këto. Allahu ju begatofte!

Data e kësaj pyetjeje është më 13/2/1423 hixhri.

Përktheu: Idriz Manushi

AURETI I MUSLIMANES PËRPARA GRAVE MUSLIMANE DHE ATYRE MOSBESIMTARE

SHEJH MUHAMED NASIRUDIN ALBANI

Lavdi Allahut, Atë e lavdërojmë, prej Tij ndihmë dhe falje kërkojmë. Kërkojmë strehim tek Allahu nga e keqja e veteve dhe veprave tona. Atë që Allahu e udhëzon, nuk ka kush e humbet, ndërsa atë që e humbet Allahu, nuk ka kush e udhëzon. Dëshmoj se nuk ka të adhuruar me të drejtë përveç Allahut të Vetëm e të pashok dhe se Muhamedi është robi dhe i Dërguari i Tij.

﴿ يَا أَيُّهَا الَّذِينَ آمَنُوا اتَّقُوا اللَّهَ حَقَّ تَقَاتِهِ وَلَا تَمُوتُنَّ إِلَّا وَأَنتُمْ مُسْلِمُونَ ﴾

“O ju të cilët keni besuar! Kijeni frikë Allahun ashtu si i takon Atij dhe vdisni vetëm duke qenë muslimanë!”⁷³

﴿ يَا أَيُّهَا النَّاسُ اتَّقُوا رَبَّكُمُ الَّذِي خَلَقَكُمْ مِنْ نَفْسٍ وَاحِدَةٍ وَخَلَقَ مِنْهَا زَوْجَهَا وَبَثَّ مِنْهُمَا رِجَالًا كَثِيرًا وَنِسَاءً وَاتَّقُوا اللَّهَ الَّذِي تَسَاءَلُونَ بِهِ وَالْأَرْحَامَ إِنَّ اللَّهَ كَانَ عَلَيْكُمْ رَقِيبًا ﴾

“O njerëz! Frikësojuni Zotit tuaj, i Cili ju krijoi prej një njeriu, ndërsa prej atij krijoi bashkëshorten e tij, kurse prej këtyre të dyve krijoi shumë meshkuj e femra. Frikësojuni Allahut, me emrin e të Cilit ju kërkoni të drejtat e ndërsjella dhe ruani lidhjet farefisnore, se vërtet, Allahu është përherë Mbikëqyrës mbi ju.”⁷⁴

﴿ يَا أَيُّهَا الَّذِينَ آمَنُوا اتَّقُوا اللَّهَ وَقُولُوا قَوْلًا سَدِيدًا يُصْلِحْ لَكُمْ أَعْمَالَكُمْ وَيَغْفِرْ لَكُمْ ذُنُوبَكُمْ وَمَنْ يُطِيعِ اللَّهَ وَرَسُولَهُ فَقَدْ فَازَ فَوْزًا عَظِيمًا ﴾

“O besimtarë! Frikësojuni Allahut dhe thoni vetëm të vërtetën. Ai do t’jua bekojë veprat tuaja dhe do t’jua falë gjynahet. Kush i bindet Allahut dhe të Dërguarit të Tij, do të arrijë një fitore madhështore.”⁷⁵

Pas kësaj:

Më është dukur e arsyeshme në këtë tubim të begatë inshaAll-llah, që t’i përkujtoj vëllezërit prezentë dhe ata të cilëve u mbërrin fjala ime, për një

⁷³ Al Imran 102.

⁷⁴ En-Nisa’ 1.

⁷⁵ El Ahzab 70.

çështje të cilën e mendoj se shumë prej muslimanëve janë të shkujdesur ndaj saj. Secili prej jush është në dijeni se përkujtimi i njerëzve rreth asaj që janë të shkujdesur, apo nuk janë në dijeni, është më parësore sesa biseda rreth çështjeve të cilat shpesh i kanë dëgjuar nga hatibët, mësuesit, vaizët, radiot apo nga mjetet e tjera të cilat i ka mundësuar Allahu në këtë kohë. Përderisa Pejgamberi sal-lAllahu alejhi ue sel-lem ka thënë:

خير الناس أنفعهم للناس

“Më i miri prej njerëzve, është ai më i dobishmi për njerëzit”, atëherë nuk ka dyshim se ne nxjerrim nga ky hadith, se të bërit dobi njerëzve arrihet duke i mësuar atyre çfarë nuk e dinë, si dhe përkujtimi i tyre të asaj që kanë harruar (apo janë të shkujdesur).

Prej këtij aspekti, është edhe njohja e auresit të gruas muslimane përpara gruas muslimane. Kjo, sepse në disa libra të fik’hut përmendet se auresi i saj përpara grave të tjera muslimane, është sikur e burrit përpara burrit; dmth çfarë është mes kërthizës dhe gjunjëve. Kjo do të thotë se gruas muslimane i lejohet që përpara motrës së saj muslimane të shfaqet me pjesën e sipërme të trupit, apo me gjysmën e trupit të saj të zbuluar! E njëjta gjë vlen edhe për pjesën poshtë gjunjëve!

Ajo që dua t’ju përkujtoj përpara çdo gjëje, është fakti se kjo dispozitë nuk ka argument në Kuran dhe as në Sunetin e Pejgamberit sal-lAllahu alejhi ue sel-lem. Gjëja tjetër, është se Libri i Allahut na mëson të kundërtën e këtij tolerimi në përcaktimin e auresit të gruas përpara motrës së saj muslimane.

Dijetarët e tefsirit përmendin se bukuria e gruas është dy llojesh:

- Bukuri (stoli) e dukshme
- Dhe bukuria (stoli) e fshehur, dhe këtë ndarje e kanë marrë nga dy ajete fisnike.

Ajeti i parë: thotë Allahu tebareke ue teala:

وَلَا يُبْدِينَ زِينَتَهُنَّ إِلَّا مَا ظَهَرَ مِنْهَا

“Dhe të mos i shfaqin stolitë e tyre, përveç atyre që janë të dukshme (ose ajo që nuk mund të fshihet).”⁷⁶

Mos t’i shfaqin stolitë (dhe bukuritë) e tyre burrave të huaj, përveç atyre që janë të dukshme. Pra, bukuria e dukshme ka lidhje me njerëzit e

⁷⁶ En-Nur: 31.

huaj, dhe bukuri e dukshme, sikurse është vërtetuar në më shumë se një hadith nga Pejgamberi sal-Allahu aljehi ue sel-lem, sa i përket femrës konsiderohen vetëm duart dhe fytyra, ndërsa pjesët e tjera janë bukuri të fshehura, të cilat nuk është e lejuar që të shfaqen përpara të huajve.

Ndërsa bukuria e fshehur, është ajo të cilën Allahu azze ue xhel-le e ka lejuar që të shfaqet përpara të gjithë mahremëve⁷⁷, dhe përpara gjitha grave muslimane, në ajetin e njohur ku Zoti ynë azze ue xhel-le thotë [në suren en-Nur: 31]:

وَلَا يُبْدِينَ زِينَتَهُنَّ إِلَّا لِبُعُولَتِهِنَّ أَوْ آبَائِهِنَّ

“Dhe të mos ua shfaqin stolitë e tyre, përveçse bashkëshortëve të tyre, ose baballarëve të tyre”, e kështu Zoti ynë azze ue xhel-le vazhdon të përmendë mahremët e tjerë, derisa thotë:

أَوْ نِسَائِهِنَّ أَوْ مَا مَلَكَتْ أَيْمَانُهُنَّ

“Ose grave të tyre, ose atyre që i kanë nën zotërim (si skllave).”⁷⁸

Fjala e Allahut tebareke ue teala **“Ose grave të tyre”,** përmban argument të qartë se gruas muslimane, i lejohet të shfaqë bukurinë e saj të fshehtë që ia shfaq babait të saj, vëllait, motrës dhe mahremëve të tjerë; po ashtu edhe auret i gruas përpara gruas muslimane është e kufizuar me këtë “bukuri të fshehtë”. Në mënyrë që ne të kuptojmë se çfarë është “bukuri e fshehtë”, ne duhet të kthehemi tek ajo që kanë qenë gratë në xhahiljet (në periudhën para Islame), përpara se ato të pranonin Islamin. Në momentin që ato e besuan Allahun, Pejgamberin dhe e morën Islamin për fë, u zbritën këto dispozita të cilat i sqarojnë këtyre grave, se çfarë lejohet të shfaqet përpara të huajve – dhe ato janë vetëm fytyra dhe duart e që janë “bukuri e dukshme” – dhe gjithashtu çfarë lejohet të shfaqin përpara mahremëve, e këto janë “bukuri e fshehtë”.

Çfarë është “bukuri e fshehtë”?

⁷⁷ Gruaja ka për mahrem, dhe e ka të lejuar që të shfaqet përpara babasë së saj, djalit, vëllait, xhaxhasë, dajës, nipit nga ana e vëllasë, nipit nga ana e motërs. Këto janë shtatë kategori ku shkak i të qenit mahrem, është lidhja fisnore. Po të njëjtit persona bëhen mahrem nga gjidhënia; d.m.th. babai i saj nga gjidhënia, vëllai i saj nga gjidhënia e kështu me rradhë. Gjithashtu tek mahremët bëjnë pjesë edhe vjehërri, djalit i burrit, burri i nënës dhe burri i vajzës (d.m.th. dhëndërri). Këta katër të fundit, shkak i të qenit mahrem është lidhja martesore. (shp)

⁷⁸ En-Nur: 31.

Këtu duhet të ndalemi pak tek komentimi që dijetarët i kanë bërë thënies së Allahut tebareke ue teala:

وَلَا يُبْدِينَ زِينَتَهُنَّ إِلَّا لِبُعُولَتِهِنَّ

“Dhe të mos ua shfaqin stolitë e tyre, përveçse bashkëshortëve të tyre”, ajeti. Çfarë është për qëllim me **“dhe të mos ua shfaqin stolitë e tyre”**?

A është për qëllim stolia (bukuria) në vetvete? Apo vendi i stolisë (dhe i bukurisë)? A është kuptimi i ajetit: të mos ua shfaqin vendet e stolive, edhe pse ato vende (dhe pjesë trupi) nuk janë të zbukuruara me stoli? Apo është për qëllim: mos t'i shfaqin ato pjesë (të trupit) kur janë të zbukuruara me stoli?

Dijetarët kanë dy mendime dhe padyshim që mendimi i saktë që dijetarët e tefsirit e kanë përkrahur është: të mos ua shfaqin vendet e stolive, dhe nuk është për qëllim: të mos ua shfaqin stolitë.

Kjo, për arsye se, nëse gruaja merr një varëse dhe e vendos në gjoks, apo në dorë, atëherë ajo e ka shfaqur stolinë e saj; a mos gruaja është ndaluar nga kjo? Përgjigja: Jo! Mirëpo gruaja është ndaluar nga shfaqja e stolisë në momentin kur është në vendin e saj (d.m.th. në pjesët e trupit).

Pra, qëllimi i ajetit **“dhe të mos ua shfaqin stolitë e tyre”,** d.m.th. vendet e stolive, duke përjashtuar mahremët, e më pas gratë muslimane sikurse thamë më sipër. Kjo na përkujton, se ka pjesë të trupit që edhe sot e kësaj dite, nuk ka qenë prej zakonisht të grave që të vendosin stoli në to. Për shembull, a vendosen stolitë në kofshë? Përgjigja: Jo! A vendosen stolitë në shpinë? Përgjigja: Jo! A vendosen stolitë në gjinj? Përgjigja: Jo! A vendosen stolitë nën sqetull? Përgjigja: Jo! Sa do që të numëroni nga pjesët e trupit, përgjigja do të jetë jo dhe jo.

Pra, Zoti ynë tebareke ue teala në këtë ajet, u ka lejuar grave që mahremëve të tyre t'i shfaqin vendet ku vendosen stolitë, e jo tjetër gjë. Ka lejuar të shfaqen pjesët e trupit ku vendosen stolitë, e asgjë më tepër se kaq.

Në mënyrë që të përforcojmë këtë kuptim, ne duhet të kujtojmë thënien e Pejgamberit sal-lAllahu alejhi ue sel-lem:

المرأة عورة ، فإذا خرجت استشرفها الشيطان

“Femra është auret, e nëse ajo del, atëherë shejtani e vështron atë (dhe e zbukuron në sytë e burrave)”, d.m.th. ai e shikon dhe e frymëzon me

gjëra që e provokojnë, si për shembull kur dikush i thotë: “Mirë se vjen! Sa e bukur qenke! Sa e mirë qenke! Sa e ëmbël”, e kështu me rradhë.

“Femra është auret, e nëse ajo del, atëherë shejtani e vështron atë (dhe e zbukuron në sytë e burrave).” Pra, gruaja është auret e gjitha, përveç pjesëve që janë bërë përjashtim nga Sheriati. Jemi njohur se Sheriati sa i përket bukurisë së dukshme, më e shumta që është bërë përjashtim (për të shfaqur) përpara të huajve, janë vetëm fytyra dhe duart. E sa i përket mahremëve, janë bërë përjashtim vendet e stolive. Mirëpo cilat janë vendet e stolive që kanë qenë në kohën e Pejgmaberit sal-Allahu alejhi ue sel-lem? Ato janë të kufizuara dhe stolitë vendosen në vende të njohura:

E para prej tyre: byzylykët që vendosen në kyç të dorës.

E dyta: *ed-deblexh* [lloj byzylyku i trashë], që vendoset në krahun e gruas, në kollap.

E treta: *et-tauk*, që është një lloj varseje që vendoset në qafë dhe në një pjesë të kraharorit.

Dhe në fund: *el khalkhaal* [byzylyk këmbë], për të cilin Zoti ynë azze ue xhel-le ka përmendur dhe ka sqaruar se bën pjesë tek “bukuritë e fshehta”, kur ka thënë:

وَلَا يَضْرِبْنَ بِأَرْجُلِهِنَّ لِيُعْلَمَ مَا يُخْفِينَ مِنْ زِينَتِهِنَّ

“Dhe të mos i përplasin këmbët (për tokë), në mënyrë që të mos duken stolitë e tyre të fshehta (që të mos dëgjohet zëri i kërcitjes së byzylykut të këmbëve).”⁷⁹

Gruaja e cila devijonte, qoftë edhe pak nga mbulesa fetare dhe nga morali Islam që gruaja muslimane duhet të ketë, i rrihte këmbët (për tokë), në mënyrë që të dëgjohej zhurma e zileve që vendoseshin në *khalkhaal*; kjo gjë jepte një tingëllimë që tërhiqte shikimet e burrave drejt saj.

Kështu vepronin disa gra, sidomos në fillim të Islamit kur ato sapo kishin hyrë në Islam. Allahu tebareke ue teala i edukoi ato me këtë ajet dhe ka thënë:

وَلَا يَضْرِبْنَ بِأَرْجُلِهِنَّ لِيُعْلَمَ مَا يُخْفِينَ مِنْ زِينَتِهِنَّ

⁷⁹ En-Nur: 31.

“Dhe të mos i përplasim këmbët (për tokë), në mënyrë që të mos duken stolitë e tyre të fshehta (që të mos dëgjohet zëri i kërcitjes së byzylykut të këmbëve).”⁸⁰

Pra, kjo është stolia e fundit që njihet në kohën e parë të Islamit.

Nga ajeti i mëparshëm mësuam se Allahu azze ue xhel-le i ka lejuar grave që të shfaqin vendet e stolive. Në këtë mënyrë na bëhet e qartë se cilat janë ato pjesë të trupit që gruas i lejohet t’i shfaqë përpara babait së saj, vëllait, nipit dhe në fund fare përpara grave muslimane.

Pra, kemi dorën, parakrahun deri aty ku vendosej *ed-deblexh*. Më pas kemi kokën, sepse ka stoli që vendosen në veshë dhe në qafë, sikurse e përmendëm më lart. Pas kësaj kemi këmbën dhe një pjesë e kërcirit, pjesë ku vendoset *khalkhaali*. Këto janë pjesët që Allahu azze ue xhel-le i ka lejuar gruas që t’i shfaqë përpara mahremëve të saj, e njëkohësisht edhe përpara motrës së saj muslimane.

Po si jetojnë sot muslimanët nëpër shtëpitë e tyre? Ata jetojnë me një zhveshje, me një zbulim që më shumë i ngjan grave që nuk e njohin fënë e Allahut tebareke ue tealala. Unë nuk e di sesa zhveshje ka në këto shtëpia, sepse unë jam i ri në këto vende, mirëpo tek ne në Siri dhe në Egjipt.. fol sa të duash rreth tolerimit që kanë njerëzit në shtëpitë e tyre në çështjen e zhveshjes. Gruaja zbulon një pjesë të madhe nga trupi i saj, më shumë se ajo që Allahu i ka lejuar të shfaqë; ato pjesë të lejuara janë vetëm vendet e stolive.

Për shembull: jemi sprovuar me rrobat e shkurta që nuk kanë mëngë, po ashtu me patallonat e shkurta që shfaqin kofshët.

Gratë sot, nënat dhe vajzat veshin të tilla rroba të shkurta. Vajza ulet përpara nënës së saj, madje përpara vëllait djalosh të ri, i cili është i mbushur me freski dhe epsh; ajo e ngre këmbën dhe e vendos mbi këmbë, e kështu kofsha e saj i duket lakuriq! E me çfarë preteksti?! Me pretekstin se s’ka njerëz të huaj dhe se ky është vëllai i saj! Kjo gjë është në kundërshtim me ajetin e parapërmendur, sepse siç thamë, Allahu ka lejuar shfaqjen e vendeve të stolive. Kofshët nuk kanë qenë ndonjëherë vende stolie, e ndoshta nuk do të jenë kurrë.

Në këtë formë gruaja del përpara vëllait të saj, pa përmendur që ajo del me parakrahë (kollapë) të zbuluar përpara babait të saj. Kjo është në kundërshtim me argumentin e lartpërmendur:

⁸⁰ En-Nur: 31.

وَلَا يُبْدِينَ زِينَتَهُنَّ إِلَّا لِبُعُولَتِهِنَّ

“Dhe të mos ua shfaqin stolitë e tyre, përveçse bashkëshortëve të tyre”. Kollapi (parakrahu, pjesa e sipërme e krahut) nuk është vend stolie, gjithashtu sqetulla nuk është vend stolie. Të gjitha këto janë të ndaluara (që të zbulohen) dhe bëjnë pjesë tek fjala e Pejgamberit sal-Allah u alejhi ue sellem:

المرأة عورة

“Femra është auret”.

Ndodhin gjëra edhe më të mëdha sesa këto. Gruaja që është nënë, hyn në banjë – në banjën e shtëpisë – dhe e urdhëron vajzën e saj që t’i lajë shpinën; e kjo gjë bëhet duke zbuluar shpinën, gjinjtë dhe pjesën e sipërme të trupit sikurse thamë, e kjo bëhet pa asnjëlloj problemi. Prej nga ka ardhur kjo gjë, në një kohë kur ajeti është i qartë dhe Zoti ynë azze ue xhel-le i ka lejuar gruas që të zbulojë vetëm vendet e stolive, ndërsa gjoksi nuk është vend stolie, as shpina nuk është vend stolie.

Selefët e devotshëm radijAllahu anhum, në shtëpitë e tyre jetonin brenda kufijve të zbulimit që Allahu i ka lejuar atyre, dhe nuk ka ekzistuar kjo zhveshje që është përhapur në vendet muslimane sot.

Unë dëshiroj të përkujtoj këtë kuptim të qartë që është në Kuran, të edukohemi me edukatën e Kuranit, të edukojmë me këtë gjë gratë tona, vajzat tona, e mos të ndikohemi nga ambjentet që na rrethojnë, sepse në të shumtën e rasteve këto ambjente tregojnë pasimin e zakoneve të Europës mosbesimtare. Pra, ne kemi për detyrë që të qëndrojmë tek ky ajet:

وَلَا يُبْدِينَ زِينَتَهُنَّ إِلَّا لِبُعُولَتِهِنَّ

“Dhe të mos ua shfaqin stolitë e tyre, përveçse bashkëshortëve të tyre”.

Më pas, Allahu teala ka thënë:

أَوْ نِسَائِهِنَّ

“Ose grave të tyre” dhe këtu bëhet fjalë për gratë muslimane.

Këtu kemi një tjetër edukatë që kemi për detyrë të tregohemi të vëmendshëm ndaj saj, e cila ndodh në këto vende që Allahu tebareke ue teala

i ka begatuar me pasuri të mëdha. Këtë fatkeqësi nuk e kam parë në vendet e tjera të varfra, e ajo është përdorimi gjithnjë e më shumë i shërbëtove mosbesimtare – pa përmedur shërbëtorët – për t’u shërbyer atyre në shtëpi.

Shërbëtorja mosbesimtare hyn në dhomat e gruas muslimane, ndërsa ajo është e veshur sikurse përpara burrit të saj! Kjo nuk lejohet! Gruaja muslimane duhet të mbulohet përpara gruas mosbesimtare, ashtu siç mbulohet përpara një burri musliman, pa përmendur atë që është mosbesimtar.

Gruas muslimane nuk i lejohet që të zbulojë përpara gruas mosbesimtare ndonjë pjesë të stolisë së saj të fshehtë, sepse Allahu azze ue xhel-le në realitet i ka lejuar asaj që “vendet e stolive” t’i zbulojë përpara grave muslimane. Jo më kot Allahu tebareke ue teala kur ka përmendur gratë që lejohet zbulimi përpara tyre, i ka bashkëngjitur me gratë muslimane duke thënë:

أَوْ نِسَائِهِنَّ

“Ose grave të tyre”, dhe nuk ka thënë ose “grave”, sepse do të përfshiheshin të gjitha gratë, qofshin ato muslimane apo mosbesimtare. Allahu nuk e ka thënë këtë gjë, mirëpo ka thënë:

أَوْ نِسَائِهِنَّ

“Ose grave të tyre”.

Pra, gruas muslimane nuk i lejohet që të bëjë lëshime me shërbëtove mosbesimtare, e të shfaqet përpara saj ashtu siç shfaqet përpara grave muslimane sipas kufijve që përmenden nga Libri i Allahut tebareke ue teala.

Kjo është ajo që dëshirova të përkujtoj dhe përkujtimi i bën dobi besimtarëve.

Përktheu: Besmir Cacani

HISTORIA E SALIHUT ALEJHIS-SELAM

SHEJH ABDURRAHMAN ES-SADIJ

Populli i Themudit – populli i dytë i Adit – banonin në Hixhër dhe përreth tij. Ata posedonin dhen të shumta, kishin bujqësi dhe të mbjella. Begatitë vazhduan pandërprerë. Ata ndërtonin pallate të stolisura nëpër fusha, ndërsa nëpër male ndërtonin shtëpia të skalitura me mjeshtëri. Mirëpo, ata i zhvlerësuan mirësitë dhe i mohuan; adhuruan të tjerë veç Allahut, kështu që Allahu i dërgoi vëllaun e tyre Salih, që ishte nga i njëjti fis. Ata ia njihnin prejardhjen, pozitën, vlerën, pjekurinë, sinqeritetin dhe besnikërinë e tij. Salihu i bëri thirrje për tek Allahu, që t’ia kushtonin adhurimin Allahut dhe të braktisnin çfarë adhuronin përveç Tij. Ai gjithashtu ia përkujtoi mirësitë e Allahut dhe ngjarjet e popujve afër tyre, mirëpo të paktë ishin ata që e pasuan.

Pasi i përkujtoi dhe ia ngriti argumentet e obligueshmërisë së veçimit të Allahut me adhurim, ata u rënduan nga kjo gjë, u larguan, u treguan mendjemëdhenj dhe thanë:

يَا صَالِحُ قَدْ كُنْتَ فِينَا مَرْجُوًّا قَبْلَ هَذَا

“O Salih! Ti ke qenë i nderuar mes nesh dhe shpresa jonë para kësaj (fjale).”⁸¹ D.m.th. se mendonim se do të na e kaloje të gjithë neve, për shkak të pjekurisë tënde, të moralit tënd të lartë dhe sjelljes tënde të bukur.

Ky është pohim nga ana e tyre, se Salihu i posedonte këto gjëra para se t’i thoshte ato fjalë. E vetmja gjë që e beri të zbriste nga ajo pozitë që kishte tek populli i tij, është [fakti] se i bëri thirrje që të adhuronin Krijuesin në vend që të adhuronin krijesat, po ashtu i bëri thirrje për tek lumturia e përhershme. E vetmja gjë është se i kundërshtoi baballarët e tyre të devijuar, të cilët kanë qenë edhe më të devijuar se ata. Pas kësaj, Salihu i solli një argument madhështor, një provë të qartë dhe mirësi për gjithë fisin e për gjitha familjet e tij.

Salihu tha: “Kjo është deveja e Allahut – që nuk i ngjason asnjë deve në paraqitje, në vlerë dhe dobi për ju – dhe është argument për sinqeritetin tim dhe mëshirën e gjerë të Zotit tuaj, andaj lëreni të ushqehet në tokën e Allahut, sepse Allahu do ta funizojë, ndërsa ju do merrni dobitë e saja. Ajo do të pijë

⁸¹ Hud 62.

ujë një ditë vetme, pastaj do t'i japi qumësht fisit me gjithë familjet e saja, ku secili nga ju do të mbushë enën e vet. Ditën tjetër e keni ju rradhën për ujë.

Kështu vazhduan, aq sa dëshiroi Allahu.

Në qytetin e tyre ishin nëntë persona shejtanë, të cilët i bënë shumë oponentë Salihut dhe asaj më të cilën kishte ardhur. Ata bëheshin pengesë nga rruga e Allahut, bënë shkatërrime në tokë dhe nuk ndreqnin. Salihu i kishte paralajmëruar nga therja e devesë në kohën kur shikoi mendjemadhësinë dhe refuzimin e tyre të së vërtetës. Gjëja e parë që bënë ata njëerëz të këqinj, ishte mbledhja në një tubim të hapur, që të binin dakort për therjen e devesë. Ata ranë dakort dhe për këtë gjë zgjodhën njeriun më të keq të fisit. Për këtë gjë, Allahu i Lartësuar ka thënë:

إِذِ انبَعَثَ أَشْقَاهَا

“Kur u ngrit më i keqi i tij (për të therur devenë).”⁸²

D.m.th. kur ranë dakort dhe e zgjodhën, e dërguan me këtë mision. Ai u përgatit dhe e mori përsipër që ta therte devenë, ndërsa të gjithë ata ishin të kënaqur, madje urdhëronin që të bëhej. Ai e theri devenë, andaj ajo therje ishte lajmëtare e shkatërrimit të fisit me gjitha familjet që kishte.

Kur Salihu e mori vesh çështjen dhe e shikoi atë pamje të tmerrshme, kuptoi që dënimi ishte i pakthyeshëm, sepse krimi i kishte kaluar kufijtë dhe nuk kishte mbetur ndonjë shpresë ta që të ndreqeshin.

Salihu i tha atyre: “Vazhdoni edhe tre ditë në shtëpitë tuaja, sepse ky është premtim i pathyeshëm”. Me këto fjalë, Salihu i tërhoqi vëmendjen të gjithëve.

Gjatë këtyre tre ditëve, nëntë burrat ranë dakort për diçka edhe më të rëndë se therja e devesë, për vrasjen e Salihut. Ata u pajtuan, dhanë fjalën, bënë betime të mëdhaja dhe e mbajtën çështjen të fshehur, nga frika se mos familjarët e tij të bëheshin pengesë, sepse Salihu ishte nga një shtëpi fisnike dhe e nderuar.

Ata thanë: “Do ta sulmojmë Salihun dhe familjen e tij natën, e nëse mendojnë se e kemi vrarë ne, atëherë do t'i betohemi fisit të tij që nuk e kemi parë vrasësin e tyre dhe se ne jemi të sigurtë”.

⁸² Esh-Shems 12.

Ata e pergatitën këtë kurth të madh, mirëpo ata thurin kurthe dhe Allahu gjithashtu thur kurthe në mbrojtje të peygamberit të Tij Salih.

Kur ata u fshehën rrëzë një mali, në pritje të mundësisë për të vrarë Salihun, Allahu nisi dënimin e Tij ndaj tyre, duke i bërë paraprijës të popullit të tyre në dënimin e zjarrit të Xhehenemit. Allahu lëshoi një shkëmb nga maja e malit që i shtypi dhe u vranë në formën më të tmerrshme.

Pas tre ditësh, popullit të Salihut i erdhi një zë i fuqishëm nga lart dhe një tërmet nga poshtë që i bëri pluhur.

Allahu e shpëtoi Salihun dhe besimtarët që ishin me të. Salihu iku nga populli i tij duke thënë:

يَقُومُ لَقَدْ أَبْلَغْتُكُمْ رَسُولًا مِنْ رَبِّي وَنَصَحْتُ لَكُمْ وَلَكِنْ لَا تُحِبُّونَ النَّصِيحِينَ

“O populli im! Unë ju solla mesazhin e Zotit tim dhe ju këshillova, por ju nuk i donit ata që këshillojnë.”⁸³

DOBITË E KËSAJ HISTORIE

❖ **Prej dobive** është se: të gjithë peygamberët kanë një thirrje të vetme dhe se kush e përgënjeshton njërin prej tyre, atëherë ai i ka përgënjeshtuar të gjithë, sepse po përgënjeshton të vërtetën me të cilën ka ardhur secili prej tyre. Për këtë gjë, Allahu thotë në secilin tregim që “populli i Nuhut i përgënjeshtroi peygamberët”, “populli i Adit i përgënjeshtroi peygamberët”, “populli i Themudit i përgënjeshtroi peygamberët”.

❖ **Pre dobive** është se: dënimet e Allahut ndaj popujve zullumqare, kanë ardhur pasi i kanë kaluar gjitha kufijtë dhe kanë bërë çdo krim. Mohimi dhe përgënjeshtrimi i tyre e bënë obligim shkatërrimin, mirëpo shkatërrimi i tyre u bë i pashmangshëm kur kaluan kufijtë e krimeve, sepse Allahu i Lartësuar është në pritje; jep afat, pastaj jep afat derisa t’i dënojë me plotfuqinë e Tij.

❖ **Prej dobive** është se: besimet e kota të ngulitura tek njerëzit, të cilat janë të marra nga njerëz [të tjerë] prej të cilëve kihet mendim të mirë për ta, sikur baballarët apo të tjerë, këto besime janë prej pengesave më të mëdha për pranimin e të vërtetës. Faktikisht, kjo as që ka ndonjë vlerë, as ndonjë rëndësi dhe as që ka ndonjë pozitë tek argumentet e sakta që vlejné për të faktuar diçka, andaj gjëja më e madhe më të cilën populli i Salihut e refuzuan

⁸³ El Earaf 79.

thirrjen e tij, ishte thënia: “A po na ndalon që të adhurojmë atë çfarë kanë adhuruar baballarët tanë?!”

Të gjitha popujt përgënjeshtroese kanë thënë duke e refuzuar thirrjen e peygamberëve:

إِنَّا وَجَدْنَا آبَاءَنَا عَلَىٰ أُمَّةٍ وَإِنَّا عَلَىٰ آثَرِهِمْ مُّهْتَدُونَ

“Ne i kemi gjetur etërit tanë në këtë fe dhe ne po ndjekim gjurmët e tyre.”⁸⁴

Kjo metodë vazhdon të ketë pasuesit e saj nga njerëzit e të kotës. Shejtanët e kanë shtruar këtë rrugë që t'i pengojnë njerëzit nga rruga e Allahut. Dihet se rruga e peygamberëve është rruga e udhëzimit dhe e vërtetës, andaj a ka pas të vërtetës diçka tjetër veç humbjes?

Përktheu: Besmir Cacani

⁸⁴ Ez-Zuhruf 22.